



HARUN JAHJA

KRIJESA TË MREKULLUESHME



Ne këtë libër ju do të hasni një numër të madh gjallesash, disa prej të cilave mund t'i njihni, ndërsa disa të tjera mund të mos i keni parë kurrë më parë. Ju do të mbeteni të mahnitur me aftësitë e mrekullueshme të këtyre gjallesave, të cilat janë në gjendje të kryejnë detyra kaq të vështira.

S'ka dyshim se e gjitha kjo do t'ju shtyje të mendoni rreth fuqisë dhe njësjterisë së krijimit të Allahut, Zotit fuqiplotë, i Cili duhet falenderuar për të gjitha këto miresi. Kjo është pikërisht ajo që Zoti kërkon prej nesh.

RRETH AUTORIT



"Autori, i cili shkruan me pseudonimin HARUN JAHJA, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Ka studiuar artet në universitetin Mimar Sinan të Stambollit, si dhe filozofi në Universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, autori ka publikuar libra të shumtë në fusha të ndryshme, si ato politike, fetare dhe shkencore. Harun Jahja njihet si një autor që ka shkruar punime tepër të rëndësishme për të nxjerrë në shesh mashtrimet e evolucionistëve, pavlefshmërinë e pretendimeve të tyre, si dhe anët e errëta që lidhin Darwinizmin me disa ideologji shkatërrimtare. Shumë prej librave të tij janë përkthyer në Anglisht, Gjermanisht, Frengjisht, Italisht, Spanjisht, Portugalisht, Shqip, Arabisht, Polonisht, Rusisht, Boshnjakisht, Indonezisht, Tatarisht, Urdu dhe Malaj. Librat e Harun Jahjas u drejtohen të gjithë njerëzve, muslimanëve dhe jomuslimanëve, pavarësisht nga raca, moshë e kombësia, sepse ata përqendrohen në një qëllim të vetëm, i cili është zgjerimi i diapazonit të mendjes së lexuesve nëpërmjet paraqitjes së shenjave të ekzistencës së përjetshme të Zotit."

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ

Reeth autorit dhe veprave të tij

Autori, i cili shkruan me pseudonimin HARUN JAHJA, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Pasi mbaroi shkollën tetëvjeçare dhe të mesme në Ankara, ai studioi artet në universitetin Mimar Sinan të Stambollit, si dhe filozofi në Universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, autori ka publikuar libra të shumtë në fusha të ndryshme, si ato politike, fetare dhe shkencore. Harun Jahja njihet si një autor që ka shkruar punime tepër të rëndësishme për nxjerrë në shesh mashtrimet e evolucionistëve, pavlefshmërinë e pretendimeve të tyre, si dhe anët e errëta që lidhin Darwinizmin me disa ideologji shkatërrimtare.

Pseudonimi i tij përbëhet nga emrat "Harun" (Aron) dhe Jahja (Gjon), për të përkujtuar këta dy profetë që luftuan kundër mosbesimit. Vula e Profetit, e cila gjendet në kapakun e librave të autorit përmban një kuptim simbolik që ka lidhje me përmbajtjet e tyre. Kjo vulë përfaqëson Kuranin, i cili është libri dhe fjala e fundit e Allahut dhe Profetin, i cili është profeti i fundit. Nën udhëheqjen e Kuranit dhe Sunetit, autori ka për qëllim të hedhë poshtë të gjitha bazat e ideologjive anti-fetare, në mënyrë që të shuhet të gjitha kundërshtimet ndaj fesë.

Të gjitha këto punime të autorit përqendrohen rreth një qëllimi: transmetimi i mesazhit të Kuranit për të gjithë njerëzit, duke i nxitur ata të mendojnë rreth temave të rëndësishme që kanë lidhje me besimin, si ekzistenca e Allahut, njësimi i Tij, bota tjetër etj., dhe shkatërrimi i plotë i themeleve të rrënuara të sistemeve ateiste.

Harun Jahja gëzon një reputacion të madh në një gamë mjaft të gjerë lexuesish që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, nga Polonia në Bosnje, nga Spanja në Brazil. Disa prej librave të tij janë të disponueshëm në Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Italisht, Portugalisht, Urdu, Arabisht, Shqip, Rusisht, Boshnjakisht dhe Malajo; ata janë mirëpritur nga lexuesit në të gjithë botën.

Të vlerësuar në të gjithë botën, këto punime kanë shërbyer për të ndihmuar shumë njerëz të gjejnë rrugën e besimit apo të arrijnë një kuptim më të thellë të besimit të tyre. Stili i qartë, i lehtë dhe i rrjedhshëm i këtyre librave u jep atyre disa veçori karakteristike që mund të vihen re nga kushdo që i lexon apo i shqyrton ato. Këto punime kanë pasur një ndikim të shpejtë dhe rezultate tepër të kënaqshme. Është e pamundur për ata persona, që i lexojnë këto libra me kujdes dhe mendojnë rreth tyre seriozisht që të vazhdojnë të mbrojnë filozofinë materialiste, ateizmin apo çfarëdo ideologjie apo filozofie shkatërrimtare. Edhe nëse ata vazhdojnë mbrojtjen, kjo tregon se ata bazohen në sentimentalizmin e tyre, pasi këto libra i hedhin poshtë këto ideologji që nga themelet. Sot është bërë e mundur që të gjitha lëvizjet bashkëkohore jobesimtare të pësojnë një disfatë ideologjike, në saj të koleksionit të librave të shkruar nga Harun Jahja.

S'ka dyshim se këto veçori e kanë origjinën nga urtësia dhe udhëzimi i Kuranit. Autori sigurisht që nuk ndihet krenar për veten e tij; ai synon që të jetë një mjet që ndihmon të tjerët për të gjetur rrugën e drejtë të Zotit. Për më tepër, ai nuk merr asnjë përfitim material nga librat e tij. Edhe ata që përgatisin këto libra nuk marrin asnjë përfitim material. Ata duan vetëm të fitojnë kënaqësinë e Allahut.

Duke pasur parasysh këto fakte, ata që inkurajojnë njerëzit që të lexojnë këto libra, të cilët hapin sytë e zemrës dhe ndihmojnë të tjerët të bëhen adhurues të devotshëm të Zotit, bëjnë një shërbim të paçmueshëm për fenë.

Nga ana tjetër, do të ishte humbje kohe dhe energjie përhapja e atyre librave që krijojnë konfuzion në mendjet e njerëzve dhe nuk kanë ndonjë ndikim të efektshëm në largimin e dyshimeve dhe dilemave nga zemrat e tyre, siç e ka vërtetuar dhe eksperiencia shumëvjeçare. Është më se natyrisht që libra të tillë që janë shkruar më tepër për të theksuar forcën letrare të autorit të tyre, sesa për të fituar kënaqësinë e Allahut, nuk mund të kenë kurrë një efekt pozitiv. Ata që dyshojnë në këtë, mund të shohin se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjas është triumfi ndaj mosbesimit dhe përhapja e vlerave morale të Kuranit.

Nuk duhet të harrojmë një pikë shumë të rëndësishme: Shkaku kryesor i vazhdimit të problemeve dhe konflikteve që përballojnë muslimanët sot është ndikimi ideologjik i mosbesimit. Të gjitha këto do të marrin fund kur të arrihet disfata ideologjike e mosbesimit dhe të sigurohemi që çdo njeri i njezh mrekullitë e krijimit dhe moralin kuranor, në mënyrë që të gjithë njerëzit të jetojnë me frymën e tyre. Duke marrë në konsideratë gjendjen e botës sot, e cila i çon njerëzit në një humnerë të thellë dhune, korrupsioni dhe konfliktesh, është e qartë që ky shërbim duhet të jetë i diponueshëm sa më shpejt dhe sa më efektivisht që të jetë e mundur. Përndryshe, mund të jetë shumë vonë.

Në shpresojmë që me Vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahjas do të luajnë këtë rol tepër të rëndësishëm në shekullin XXI dhe do të ndihmojnë njerëzit të fitojnë paqen, bekimin, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kuran.



HARUN JAHJA

krijesa të
mrekullueshme

The logo for ALB-Books, featuring the word "Books" in a stylized, handwritten font with a registered trademark symbol (©) to its upper right.

ALB-Books

Nëntor, 2005

Titulli i origjinalit:
Wonderful Creatures
www.harunyahya.com
Të drejtat e botimit në gjuhën
shqipe janë të rezervuara për
ALB-Books®



Përfaqësuesi i punimeve të Harun Jahjas në gjuhën
shqipe

Përgatiti
Kujtim Ereqi

Përkujdesja kompjuterike
Studio H. J. S.

Shqipëri:
Tel. 00 355 (0) 692570132
00 355 (0) 682243101

Maqedoni:
"Furkan ISM"- Shkup
Tel.: 00389 2 622360
Faks: 00389 2 622393

Kosovë
Tel. 00381637431214

E-mail: alb_books@yahoo.com
ALB-Books is a logo of Furkan ISM

Shtypur nga:
Secil Ofset
100. Yıl Mahallesi MAS-SIT Matbaacilar Sitesi
4. Cadde No: 77 Bagcilar-Istanbul / Turkey
Tel. 00902126290615

PËR LEXUESIN

●Në të gjithë librat e këtij autori, çështjet e lidhura me fenë janë trajtuar nën dritën e vargjeve kuranore dhe njerëzit janë të ftuar të mësojnë fjalët e Zotit e të jetojnë sipas tyre. Të gjitha çështjet që lidhen me ajetet e Zotit janë shpjeguar në mënyrë të tillë, që nuk lenë hapësirë për dyshim apo pikëpyetje në mendjen e lexuesit. Stili i sigurtë, i qartë dhe i lirshëm që është përdorur, bën të mundur, që kushdo në çfarëdo moshe dhe nga çdo grup shoqëror që të jetë, të mund ta kuptojë lehtësisht përmbajtjen e këtyre librave. Kjo mënyrë e efektshme dhe e qartë e të shprehurit, i bën librat të përshtatshëm për t'u lexuar me një të ulur të vetme. Madje edhe ata që e hedhin poshtë me ashpërsi botën shpirtërore, ndikohen nga faktet e treguara në këta libra dhe nuk munden të mohojnë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

●Ky libër dhe të gjitha veprat e tjera të autorit mund të lexohen nga individë ose të studiohen në grup në formën e një bashkëbisedimi. Leximi i librave nga një grup lexuesish të gatshëm për të përfituar prej tyre, do të ishte i dobishëm, pasi lexuesit mund të krijojnë lidhje me refllketimet e tyre dhe me përvojën e njëri-tjetrit.

●Përveç kësaj, do të ishte një shërbim i madh për fenë kontributi për bërjen të njohur dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë shkruar vetëm për kënaqësinë e Zotit.

●Të gjithë librat e autorit janë shumë bindës.

●Për ata që dëshirojnë t'u komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, një nga mënyrat më ndikuese është t'i nxisin njerëzit të lexojnë këta libra.



HYRJE 8



**TERMËTET E VERBRA QË NDËRTOJNË NDËRTESA
TË LARTA 12**

VETËMBROJTJA TE KAFSHËT 16

BUSULLA NË SYTË E MËLINGONAVE 20

**BASHKËPUNIMI I MREKULLUESHËM NDËRMJET MËLINGONËS
DHE ZOGUT 24**

ZOGJTË E VEGJËL ÌNXHINIERË 29

SISTEMI NGROHËS I FLUTURËS DËMËRORE 32

SÏ E GJEJNË SALMONËT RRUGËN E TYRE? 35

SÏ JETOJNË PESHQIT NË UJË? 40

A KANË PAPAGAJTË NJOHURÏ MBI KËMINË? 44

MJESHTËRIA ÌNXHINIERËKE NË PËLHURËN E MERËMANGËS 47

NJË KRIJESË ÌNTERESANTE: NAUTILUS 50

FLUTURAT QË KANË NJOHURÏ RRETH FÏZIKËS 53

PESHKU MACE NË DETYRË 55

**ÇFARË DINÏ PËR KRIJESAT LUMËNISHENTE
(DRÏTË-PRODHUESE)? 57**

KRIJESAT LUMËNISHENTE NËNUJORE 61

ÇANTA E FJETJES SË PESHKUT PAPAGALL 64

AFTËSÏA MASKUESE E PESHKUT AKREP 67

TÏPARET ÌNTERESANTE TË KUAJVE TË DETÏT 70

PËLËVESAT: MAKËNAT FLUTURUESE 72

SHTRETËRIT E FSHEHTË NË DETE: KORALET 75

JETA NË SHKRETËTIRË 78





SISTEMI I VEÇANTË FTOHËS I GAZELËS 81

FUQIA E QUKAPIKËVE 83

KETRAT ME FAQE TË MËDHA 86

ZOGU ME KRAHËT MË TË GJATË NË BOTË: ALBATROSI 87

ARTISTËT E ZBUKURIMEVE: ZOGU TENDË 90

ZOGJTË QË NDËRTOJNË FOLE PËR PASARDHËSIT E TYRE 92

KUJTESA E FUQISHME E GRIFSHËS 95

TANKET E BLËNDUARA TË MBRETËRISË SË KAFSHËVE 96

**ZOGJTË SHTEGTARË QË MUND TË FLUTUROJNË
EDHE NATËN 97**

PASTRUESIT E DETIT 100

GJÏNKALLA E ZHURMSHME 102

ZOGJTË PASTRUES 103

PATÏNATORËT E PELLGUT QË ECÏN MBI UJË 104

KËMBËNGULJA E PESHKUT THÏTHËS 105

PESHKU ME BUZË TË KUQE 106

ÇAFKAT SHUMËNGJYRËSHE 107

PARAKETI, PAPAGALLI QË JETON NJË MUAJ PA UJË 108

NDËRTIMI I PENDËVE TË ZOGJVE 110

TEKNIKAT E FLUTURIMIT TË ZOGJVE 114

ZOGU I UJIT QË ÇAN NËPËR UJË SI NJË GËRSHERË 116

SEPJET E NGJASHME ME MOTORËT 119

PATAT E EGRA 120

SISTEMI I PAKRAHASUESHËM I SIGURISË 122


PËRFUNDIM 125



HYRJE

Në tokë jeton një numër i pafund kafshësh. Nga qentë dhe macet që i shohim çdo ditë, deri te kafshët që jetojnë nëpër pyje, çdo gjallesë ka karakteristika të mrekullueshme dhe aftësi të habitshme. Për shembull, ne habitemi kur shohim se si bletët mund të ndërtojnë hojet e përsosura të mjaltit dhe të bëjnë llogaritë përkatëse, si të ishin matematikane të afta. Kur shohim se si vepron një krokodil apo luaneshë me këlyshin e saj, çuditëmi se si kafshë të tilla mund të sillen me kaq dashuri. Ne kërkojmë një përgjigje për pyetjen se si zogjtë e vegjël që fluturojnë mijëra kilometra gjatë një shtegtimi pa ndalesa, kryejnë këtë detyrë të vështirë. Sa më shumë informacione të marrim, aq më të mrekulluar mbetemi.

Çdo gjallesë ka një ndërtim të veçantë. Disa prej tyre fluturojnë, disa notojnë, disa ecin, disa zvarriten. Për shembull, struktura e trupit të një peshku është pikërisht ashtu siç i nevojitet atij për të jetuar nën ujë. Ai ka organet, sytë dhe lëkurën e përshtatshme që i bëjnë të mundur të jetojë nën ujë.



Mushkëritë dhe pendët e zogjve kanë një ndërtim që i mundëson të fluturojnë. Nuk ka asnjë dyshim se këto krijesa nuk i kanë fituar vetvetiu këto karakteristika, me të cilat kryejnë detyra të jashtëzakonshme. Ato as nuk mund t'i kenë mësuar rastësisht detyrat që kryejnë. Nuk është e mundur për to të dinë kaq shumë gjëra, nëse dikush nuk u ka mësuar gjithçka që bëjnë. Ekziston një qenie e lartë dhe e fuqishme që na krijoi neve, sikurse edhe qeniet e tjera të gjalla. Kjo qenie është Zoti, i Cili u ka dhënë gjallesave të gjitha tiparet që zotërojnë.

Ju mund t'i njihni dhe t'i pranoni këto fakte, megjithatë shumë njerëz nuk janë të këtij mendimi. Ata pretendojnë që gjallesat i kanë fituar rastësisht të gjitha ato tipare të mrekullueshme. Ata i përmbledhin këto deklarata të pakuptimta nën emërtimin e "teorisë së evolucionit". Për më tepër, edhe pse të gjitha degët e shkencës kanë zbuluar





pavlefshmërinë e teorisë se evolucionit, këta njerëz nuk heqin dorë nga pretendimet e tyre.

Në këtë libër do të zbulojmë disa nga tiparet e mrekullueshme të disa gjallesave. Duke sjellë edhe shembuj të pohimeve të evolucionistëve, do të tregojmë, gjithashtu, se sa e pakuptimtë është kjo teori. Ndërsa do të lexoni librin, do të çuditëni kur të shihni se si gabojnë madje edhe shumë profesorë dhe shkencëtarë që besojnë në këtë teori.

Në fakt, do të ishte me shumë interes që të dhënat rreth gjallesave të grumbulloheshin në vëllime të tëra, por në këtë libër do të shqyrtohen vetëm disa shembuj. Megjithatë, edhe pse do të jenë pak shembuj, ju do të jeni në gjendje të kuptoni Madhështinë e Allahut që i krijoi këto krijesa të mrekullueshme.

Ai është Allahu – Krijuesi, Shpikësi, Dhënësi i Formës.

Atij i përkasin emrat më të bukur.

**Çdo gjë në qiej dhe në tokë e
madhëron Atë. Ai është
Ngadhënyjësi, i Dituri.**

(El-Hashr: 24)



TERMËTET E VERBRA QË NDËRTOJNË NDËRTEA TË LARTA

Termitet janë insekte të vogla, të ngjashme me milingonat. Ato janë shumë të shkathta. Foletë e tyre, që në këto figura ngjajnë si kulla të larta, janë ndërtuar nga këto gjallesa të vogla. Gjithçka është e përkryer dhe pa asnjë gabim. Termitet i ndërtojnë ato sipas një plani të caktuar. Dhomat e veçanta për të vegjëlit, për ruajtjen e ushqimit apo për mbretëreshën janë vetëm disa nga pjesët e një foleje termitesh. Sistemi i ventilimit është më i rëndësishmi. Termiteve, lëkura e të cilave është shumë e hollë, u nevojitet ajër i lagësht. Për këtë arsye, atyre u duhet të mbajnë temperaturën dhe lagështinë e folesë në një nivel të caktuar, përndryshe ngordhin. Ato bëjnë të mundur qarkullimin e ajrit nëpër fole nëpërmjet disa kanaleve të veçanta, duke përdorur ujin që vjen nga



tunelet e nëntokës të hapura nga ato vetë. Në këtë mënyrë rregullohet temperatura dhe lagështia.

A e përfytyroni dot se sa i vështirë është ky proces? Termitet duhet të veprojnë në një rregull të caktuar, duke pasur vëmendjen për shumë gjëra së bashku. Përveç kësaj, çfarë përmendëm deri tani është vetëm një përmbledhje e shkurtër e gjërave të shumta që bëjnë termitet.

Një karakteristikë tjetër e termiteve është ngritja e folesë deri në shtatë metra lartësi. Termitet janë në alarm sa herë që formohet ndonjë vrimë në folenë e tyre. Duke përplasur kokat në mur, termitet roje japin alarmin të gjithë anëtarët e tjerë të kolonisë. Pas këtij alarmi, vezët transferohen në vende të sigurta. Hyrja e dhomës ku jetojnë mbreti dhe mbretëresha bllokohet me një mur. Pjesa e dëmtuar rrethohet nga ushtarët termite, të cilët shoqërohen nga punëtorët që sjellin materialin për të rindërtuar murin. Në pak orë, zona e shkatërruar është rregulluar. Pastaj ndërtohen dhomëzat e brendshme. Termitet veprojnë sipas një plani të paracaktuar dhe secili anëtar i





kolonisë i zbaton detyrat e veta pa shkaktuar asnjë rrëmujë.

Fakti se termitet mund t'i kryejnë gjithë këto veprime në një kohë të shkurtër është tregues i komunikimit të përkryer ndërmjet tyre.

Ekziston edhe një aspekt tjetër i mrekullueshëm i jetës së termiteve që punojnë me një rregull të tillë dhe ndërtojnë mjedise të ngjashme me gradaçelat: Ato janë të verbra. Ndërsa kryejnë detyrat e tyre, ato nuk shohin asgjë. Si është e mundur që këto krijesa të veprojnë me kaq shkathtësi dhe të vënë në jetë plane të tilla?

Përgjigjja që evolucionistët i japin kësaj pyetjeje është se këto insekte i kanë fituar të gjitha këto aftësi "rastësisht". Kjo përgjigje nuk ka të bëjë aspak me të vërtetën, sepse edhe një pjesë e vetme e rregullit në koloninë e termiteve, p.sh. kanalet e ventilimit, është e mjaftueshme për të provuar që një sistem i tillë nuk mund të shfaqet rastësisht. Pa asnjë dyshim, termitet e verbëra nuk mund ta sigurojnë vetë këtë rregull të përsosur. Atyre u është dhënë nga dikush tjetër aftësia për të vepruar.

Allahu ka përmendur emrat e disa kafshëve në Kuran, duke na nxitur të mendojmë rreth tyre. Për shembull, bleta është dhënë si shembull në suren "En-Nahl", ku thuhet se bleta, e cila prodhon mjaltë, është mësuar nga Zoti për atë që i duhet të bëjë:

Zoti yt i dha instikt bletës: "Ndërto shtëpi nëpër kodra, pemë dhe gjithashtu nëpër kulmet që njerëzit ndërtojnë. Pastaj ha

O ju njerëz! Kujtoni të mirat që Allahu u dhuroi. A ka ndonjë zot tjetër që ju furnizon nga qielli e toka? Askush nuk e meriton adhurimin përveç Tij. E si pra i ktheni shpinën? (Fatir: 3)

nga të gjitha frutat dhe futu nëpër rrugët e mësuar nga Zoti yt!" Prej barkut të saj del mjaltë me ngjyra të ndryshme, në të cilin ka shërim për njerëzit. Në këto fakte ka argumente dhe mësim për njerëzit që mendojnë. (En-Nahl: 68-69)

Ashtu si bletët që përmenden në ajetet e mësipërme, termitet jetojnë sipas mënyrës që u ka mësuar Allahu, i Cili krijoi komunikimin e përkryer ndërmjet këtyre krijesave të verbëra, duke bërë të mundur që secila nga një milion termitet e çdo kolonie të kryejë detyrat përkatëse.



VETËMBROJTJA TE KAFSHËT

Nga mrekullitë më të mëdha në natyrë janë mënyrat që përdorin gjallesat për vetëmbrojtje. Shumë krijesa kanë aftësinë të vlerësojnë rreziqet e mundshme dhe të përdorin forma të ndryshme sigurie. Për shembull, termitet që përmendëm më sipër i ndërtojnë muret e kolonisë se tyre aq të trasha dhe të qëndrueshme, saqë me shumë vështirësi mund të shkatërrohen edhe me kazmë. Zogjtë shtegtarë e ndërtojnë hyrjen e folesë së tyre në një mënyrë të atillë që të ndalojnë gjarpërinjtë të hyjnë brenda. Disa merimanga kanë dhoma të caktuara në folenë e tyre, në të cilat mbeten të bllokuara insektet e tjera që, në një mënyrë apo një tjetër, kanë hyrë në fole.



Bletët, gjithashtu, marrin masa të veçanta mbrojtëse për të ruajtur kosheret e tyre. Bletë roje vëzhgojnë kosheret. Ato nuk lejojnë të hyjë aty askënd, përveç anëtarëve të kolonisë. Kur ndonjë nga rojet largohet, një tjetër bletë vjen tek hyrja e kosheres për ta zëvendësuar. Për më tepër, këto bletë roje i marrin



Zogjtë në foto ndërtojnë foletë e tyre për të ndaluar hyrjen e armiqve. Foletë e termiteve, të ngjashme me gradaçelat janë të forta si një kështjellë.



Duke ndërtuar diga nëpër përrenj e lumenj, kastorët ndalojnë rrjedhjen e ujit dhe ndërtojnë strofka të mrekullueshme për veten e tyre.

përsipër detyrat duke vënë në rrezik edhe jetën e tyre.

Kastorët i ndërtojnë strofkat e tyre nën ujë. Për të hyrë, çdonjëri duhet të kalojë nëpër një tunel të fshehtë, të njohur vetëm nga kastorët që e kanë ndërtuar atë. Në fund të tunelit, ndodhet një dhomë ku kastorët jetojnë së bashku me të vegjëlit e tyre.

Këta shembuj janë të mjaftueshëm për të kuptuar se një inteligjencë e jashtëzakonshme fshihet pas mënyrës së sjelljes të këtyre gjallesave, të cilat zbatojnë metoda kaq të efektshme për t'u vetëmbrojtur. Përveç kësaj, ju e keni vënë re që armiku i një krijese është një krijesë tjetër. Megjithatë, të gjitha krijesat i njohin armiqtë e tyre shumë mirë dhe marrin masa të ndërlikuara për t'u mbrojtur prej tyre. Është shumë e çuditshme që një termit ose një zog, pavarësisht nga mungesa e funksioneve të zhvilluara mendore, mund të njohë tiparet e një krijese tjetër.

Për ta kuptuar më mirë, mendoni veten tuaj! A mundeni ju të kuptoni që në shikimin e parë karakteristikat e një kafshe që nuk e njihni ose që nuk e keni parë më parë? A mund të dini se me çfarë ushqehet, si gjuan dhe çfarë e frikëson? Natyrisht që nuk mundeni. Ju nevojitet të lexoni një libër dhe të merrni informacion rreth kësaj krijese ose dikush t'ju flasë rreth cilësive të saj. Si është e mundur që kafshët kanë informacion rreth krijesave të tjera? A mundet që ato të kenë zbuluar vetë kush janë armiqtë e tyre, pastaj të kenë organizuar një studim mbi sjelljen dhe mënyrat e tyre të të gjuajturit, në bazë të të

cilave ato kanë zhvilluar format e përshtatshme të mbrojtjes? Natyrisht që jo. Asnjë kafshë nuk ka aftësi mendore për të bërë kërkime. Për më tepër, do të ishte absurde dhe e pakuptimtë të mendosh që kafshët mbledhin rastësisht informacion rreth armiqve të tyre, sepse dështimi në përpjekjen e parë do të thotë vdekje.

Pa dyshim është Allahu, Zoti i gjithë botës, që i mëson gjallesat si të vetëmbrohen. Fakti që jo vetëm kafshët që shohim rreth nesh, por të gjitha gjallesat në botë sillen në të njëjtën mënyrë inteligjente, vë në dukje inteligjencën dhe fuqinë e Zotit.


BUSULLA NË SYTË E MILINGONAVE

Ne kemi nevojë për udhëzues kur udhëtojmë në një vend të panjohur. Në veçanti, kur nuk dimë vendin ku po shkojmë, natyrisht që duhet të kemi një busull dhe një hartë. Harta na tregon se ku jemi, ndërsa busulla nga duhet të shkojmë. Ne e gjejmë rrugën duke përdorur këto mjete, si dhe duke pyetur njerëzit e tjerë. A e keni pyetur ndonjëherë veten se si e gjejnë rrugën e tyre krijesat e tjera? Keni pyetur veten se si një milingonë kërkon ushqim në shkretëtirë dhe kthehet përsëri në follenë e saj?

Milingonat e zeza të shkretëtirës që jetojnë në brigjet

mesdhetare të Tunizisë janë ndër ato gjallesa që i ndërtojnë foletë e tyre në shkretëtirë. Këto milingona janë shumë të afta në gjetjen e rrugës në shkretëtirën e pafund dhe në kthimin në fole pa ndihmën e një busulle ose harte.

Pasi lind dielli, temperatura në shkretëtirë mund të arrijë deri në 70°C. Milingonat lënë folenë e tyre për të gjetur ushqim mes këtij të nxehti përvëlues. Duke ngurruar, duke u kthyer e rrotulluar shpesh rreth vetes, ato ndjekin një rrugë gjarpëruese brenda një zonë që mund të jetë deri në 200 metra larg folesë.



Milingonat e vogla nuk përdorin busull për të gjetur rrugën e tyre në shkretëtirë. Harta e mësipërme tregon rrugën që ka përshkuar milingona.



Ju mund ta shikoni këtë rrugë në hartë. Por mos mendoni që një milingonë mund të humbasë rrugën për shkak të këtyre zigzakeve. Në çastin që gjendet burimi i ushqimit, milingona ndjek një rrugë të drejtë dhe kthehet në fole. Duke marrë parasysh përmasat e tyre, ky udhëtim i milingonave mund të krahasohet me kthimin e një njeriu në pikën e tij të nisjes duke marrë një rrugë të drejtë afro 35-40 kilometra larg në shkretëtirë. Si ndodh, atëherë, që një milingonë është e suksesshme në kryerjen e kësaj detyre, kur kjo është praktikisht e pamundur edhe për një njeri?

Shenjat e ndryshme, si pemët, shkëmbinjtë, lumenjtë ose liqenet që ndihmojnë në gjetjen e rrugës nuk ekzistojnë në shkretëtirë. Ka vetëm rërë në çdo anë. Edhe po të kishte shenja të tilla, nuk do bënte ndonjë ndryshim, sepse do të ishte e pamundur për një milingonë që t'i mbante mend këto shenja dhe t'i përdorte për të gjetur rrugën. Duke menduar në këtë mënyrë, çdo njeri mund ta kuptojë mirë vështirësinë e detyrës që kryen një milingonë. Ajo mund ta kryejë këtë detyrë të vështirë në saje të strukturës së veçantë të trupit të saj.

Në sytë e milingonës gjendet një sistem i posaçëm orientimi. Ky sistem, të cilin Allahu e ka vendosur te milingona, është



Ata adhurojnë në vend të Allahut zota që nuk u sjellin asnjë furnizim as nga qiejt as nga toka dhe as nuk kanë mundësi edhe në të ardhmen? Mos i përshkruani Allahut partnerë. Allahu di gjithçka, ndërsa ju nuk e dini. (En-Nahl: 73-74)

shumë më i përparuar se pajisjet mekanike që ruajnë drejtimin. Duke qenë e aftë të shikojë disa rreze të pakapshme nga njeriu, milingona mund të vendosë drejtimin dhe të dijë se ku ndodhet veriu e jugu. Në sajë të kësaj aftësie, nuk është e vështirë për të që të gjejë ku ndodhet foleja e saj dhe të kthehet tek ajo.

Njerëzit janë bërë kohët e fundit të vetëdijshëm për veçoritë dhe karakteristikat e dritës, ndërsa milingonat e njohin dhe e përdorin një karakteristikë të dritës që kur lindin. Natyrisht që një ndërtim i tillë i përsosur si syri i milingonës nuk mund të jetë rezultat i rastësisë. Syri i milingonës ka qenë i

ndërtuar në këtë mënyrë që kur ajo ka ardhur në ekzistencë. Përndryshe, milingona nuk do të mund të kthehej në fole në mes të shkretëtirës së nxehtë dhe kjo do të vinte në rrezik jetën e saj. Natyrisht, sytë e të gjitha milingonave të shkretëtirës janë të pajisura me këtë sistem që ditën e parë që ato dalin në jetë. Allahu, i Gjithëfuqishmi, është Krijuesi i syve të tyre.



BASHKËPUNIMI I MREKULLUESHËM NDËRMJET MILINGONËS DHE ZOGUT

Kudo ka mikrobe që rrezikojnë shëndetin tonë dhe shkaktojnë sëmundje. Këto mikrobe përbëjnë rrezik si për njerëzit ashtu edhe për gjallesat e tjera, të cilave u duhet të mbrojnë veten. Kur vëzhgojmë gjallesat, shohim që ato përdorin metoda të posaçme për t'u mbrojtur nga mikrobet. Për shembull, milingonat prodhojnë një lloj substance acidike që vret mikrobet. Ato e vendosin këtë lëndë në trupat e tyre dhe nëpër muret e folesë. Me fjalë të tjera, ato e dinë që jo vetëm ato vetë, por edhe foleja ku jetojnë duhet pastruar nga mikrobet.

Si mundet që një milingonë të veprojë me kaq zgjuarsis? Pa dyshim që aftësia intelektuale e milingonës nuk është e mjaftueshme për këtë. Një milingonë nuk mund të dijë as çfarë është një mikrob dhe as si të mbrohet prej tyre. Milingona nuk mund ta analizojë mikrobin dhe pastaj të zbulojë lëndën mbrojtëse. Po si e prodhon ajo këtë lëndë?

Le të mendojmë së bashku! Njerëzit vaksinohen ndaj disa sëmundjeve që shkaktohen nga mikrobe të veçanta, por këto vaksina janë pregatitur në laboratorë





Milingonat, këto krijesa kaq të vogla, janë në dijeni se mikrobet janë të dëmshme dhe marrin kundër tyre masat e duhura. Ato prodhojnë një lloj acidi që i ngordh mikrobet. Allahu i frymëzon që të veprojnë kështu.



si rezultat i shumë kërkimeve dhe eksperimenteve. Për më tepër, janë ekspertët ata që i bëjnë këto kërkime. Për ndryshe, vaksina nuk do të përdorej, sepse mund të ishte e dëmshme. Milingonat, nga ana tjetër, nuk kanë njohuri të tilla. Ato nuk mund të shkojnë në një laborator dhe të bëjnë kërkime. Është absurde të mendosh një gjë të tillë. Sigurisht, milingonat kanë lindur në këtë botë të pajisura me gjithçka që u duhet për të kryer aktivitetet e tyre jetësore.



Kjo dituri i mësohet milingonës nga një Ekzistencë Madhështore: Allahu, Zoti i të gjitha botëve dhe Krijuesi i çdo gjëje. Ai i mësoi milingonës si të mbrohet nga mikrobet.

Tani, le të marrim zogjtë si një shembull tjetër i gjallesave që mbrohen nga bakteriet. Mikrobet shqetësojnë edhe zogjtë, por këta të fundit nuk kanë një sistem në trupat e tyre që të prodhojë lëndë mbrojtëse si te milingonat. Ata kanë gjetur një zgjidhje të ndryshme, por praktikisht të ngjashme për këtë problem. Ata shkojnë e shtrihen në një fole milingonash dhe presin që milingonat të enden nëpër puplat e tyre. Milingonat, që kërkojnë ushqim, ecin nëpër pupla dhe substanca që vret mikrobet përhapet në trupin e zogut. Në këtë mënyrë, zogu pastrohet nga mikrobet. Si është e mundur që zogjtë e dinë se milingonat prodhojnë një substancë të tillë, që mund të dezinfektojë trupat e tyre nga mikrobet?

Njerëzit e kanë zbuluar sistemin mbrojtës të milingonave vetëm pas kërkimesh e hulumtimesh të shumta. Madje shumë njerëz, të cilët janë ekspertë rreth kafshëve, ende nuk janë në dijeni të këtij fakti. Ndoshta edhe ju vetë e mësuat



***Për një popull që sinqerisht është i
bindur ka argumente në krijimin
tuaj dhe në krijimin e kafshëve.***

(El-Xhathije: 4)

këtu. Zogjtë, megjithatë, e njohin këtë veti të milingonave që kur lindin. Edhe pse nuk ka njeri që t'u mësojë si të veprojnë, ata mund të përdorin milingonat për t'u pastruar nga mikrobet.

Fakti që zogjtë kanë njohuri për lëndën që prodhohet në trupat e milingonave dhe në të njëjtën kohë dinë si ta përdorin atë, na çon vetëm në një përfundim: Ky informacion u është MËSUAR atyre nga Allahu, krijuesi i të gjitha krijesave.

***... çdo gjë në qiell dhe në tokë i përket vetëm Atij. Çdo gjë i
bindet vetëm Atij. (El-Bekare: 116)***





ZOGJTË E VEGJËL ËN XHINIERË

Ju mund të keni parë foletë e zogjve në pemë, në majë të ndërtesave apo nëpër këndet e ballkoneve. Këto janë foletë e një numri të vogël zogjsh që ju i njihni, por shumë lloje të tjera jetojnë në botë dhe ndërtojnë lloje të ndryshme folesh.

Para së gjithash, zogjtë i ndërtojnë foletë në mënyrë që të jenë të lidhur me mjedisin e tyre natyror. Le të marrim në shqyrtim zogjtë e bregut të detit. Këta zogj i ndërtojnë foletë e tyre në sipërfaqe të ujit e megjithatë foleja nuk priset. Materialet e përdorura dhe forma e folesë janë të projektuara më së miri, kështu edhe nëse niveli i ujit rritet, foleja dhe të vegjëlit nuk dëmtohen. Këto krijesa kanë aftësi të lindur për të ndërtuar fole dhe nuk kanë nevojë për t'u "specializuar". Ato nuk mund ta kenë mësuar një detyrë të tillë nga përvoja, me kalimin e kohës. Nëse do të përpiqeshin të eksperimentonin dhe nëse do të gabonin, foleja do të fundosej në ujë. Megjithatë, një gjë e tillë nuk ndodh kurrë. Të gjithë zogjtë bregdetarë i ndërtojnë foletë e tyre në të njëjtën mënyrë që nga dita e parë që janë shfaqur.

Disa zogj që jetojnë në moçale i ndërtojnë muret e foleve të tyre të larta, në mënyrë që



vezët të mos bien për shkak të erës. Si është e mundur që këta zogj janë në dijeni të rrezikut të rënies se vezëve?

Një lloj tjetër zogu që jeton në zona të thata e ndërton folenë e tij nëpër shkurre dhe jo në tokë. Arsyeja pse ai vepron kështu, është ndryshimi i temperaturës. Temperatura nëpër shkurre është dhjetë gradë më e ulët se në tokë. Shumëkush nga ne nuk është në dijeni të ndryshimit të temperaturës ndërmjet shkurreve dhe tokës, por këta zogj e dinë dhe mbrojnë veten dhe të vegjëlit e tyre nga nxehtësia e madhe duke ndërtuar foletë në vende më të freskëta.



Zogjtë ndërtojnë foletë e tyre në vende të sigurta të zgjedhura prej tyre.

**Çdo gjë në qiej dhe në tokë i përket vetëm
Atij. Allahu është Ai që nuk ka nevojë për
asgjë. Ai është i Plotfuqishmi, i Falenderuari.
(El-Haxh: 64)**

A e keni pyetur ndonjëherë veten se si zogjtë, të cilët nuk kanë vetëdije dhe aftësi mendore, mund të njohin hollësi të tilla?

Këto sjellje të zogjve mund të krahasohen me ato të inxhinierëve që janë arsimuar dhe specializuar për vite me radhë në fushat e tyre. Ndërsa ndërtojnë një shtëpi, inxhinierët marrin parasysh hollësi të tilla si madhësia e ndërtesës, materialet që do të përdoren dhe vendndodhjen. Vetëm atëherë ndërtimi mund të fillojë. Siç e patë edhe në shembullin e përmendur më lart, zogjtë i ndërtojnë foletë e tyre sipas një plani. Por atyre nuk u nevojitet arsim. Ata veprojnë të frymëzuar nga Allahu dhe zbatojnë detyrat e tyre me shumë lehtësi. Këta zogj dhe ajo çka bëjnë janë një provë e krijimit të përkryer të Allahut, të Gjithëditurit që i frymëzon ata të bëjnë gjithçka.



SISTEMI NGROHËS Ë FLUTURËS DIMËRORE

Kur vjen dimri, shumë lloje insektesh që banojnë në rajone të ftohta të botës, mund të ngordhin nga i ftohti ose mungesa e ushqimit. Kjo ndodh sepse insektet janë krijesa të ndjeshme. Mirëpo ka disa përjashtime. P.sh. fluturat kukuvajkë ngajjnë me fluturat e zakonshme dhe në shikim të parë duken shumë delikate. Në të vërtetë, ato janë mjaft të forta dhe u mbijetojnë kushteve të ashpra të dimrit. Si rrjedhim, këto flutura quhen "flutura dimërore".

Ashtu si edhe fluturat e zakonshme, një flutur dimërore ka dy krahë dhe trupin, ku bashkohen krahët. Me qëllim që kjo flutur të fluturojë, duhet që temperatura e kafazit të kraharorit ku bashkohen krahët të jetë 30°C, por temperatura e mjedisit ku ato jetojnë është zakonisht 0°C apo edhe disa gradë nën zero. Si mundet që fluturat dimërore t'i mbijetojnë një të ftohti të tillë?

Çfarë i pengon ato nga ngrirja kur nuk lëvizin dhe çfarë ua bën të mundur të fluturojnë në kohë të ftohtë?

Kjo lloj fluturë është krijuar së bashku me një sistem të veçantë ngrohjeje që i mundëson





asaj të jetojë në kushtet e dimrit. Ky sistem ka disa tipare plotësuese.

Para fluturimit, fluturat dimërore tendosin në mënyrë të vazhdueshme muskujt kryesorë që janë të lidhur me krahët dhe i bëjnë krahët e tyre të dridhen. Dridhja e shpejtë e krahëve çon në një rritje të temperaturës së kraharorit të insektit. Në saje të kësaj rritjeje, temperatura e kafazit të kraharorit mund të rritet nga 0°C deri në 30°C apo edhe më tepër. Megjithatë, kjo është vetëm një nga vetitë që fluturës i nevojitet të mbijetojë. Me qëllim që të fluturojë, nuk është e mjaftueshme vetëm rritja e temperaturës, sepse ndryshimi midis temperaturës së trupit të insektit dhe mjedisit mund të rezultojë në humbje të nxehtësisë. Në të njëjtën mënyrë, sikurse ftohet një gotë me çaj të ngrohtë, edhe trupi i fluturës do të ftohej pa i mbajtur krahët duke u dridhur. Me qëllim që flutura të fluturojë dhe, si rrjedhim, të mbijetojë, një tjetër metodë është e nevojshme të ruajë nxehtësinë e prodhuar. Kjo realizohet nga një strukturë e posaçme që Allahu ka krijuar në trupin e fluturës dimërore. Fluturat dimërore janë të mbuluara me luspa të dendura që zvogëlojnë humbjen e nxehtësisë. Shkencëtarët kanë zbuluar se një flutur pa luspa ftohet dy herë më shpejt se ajo me luspa.

Ka disa mekanizma tek flutura dimërore që e mbrojnë atë nga të ftohtët.

Tiparet e përmendura më lart duhet të



kenë ekzistuar që kur këto flutura janë krijuar. Përndryshe, ato do të ishin zhdukur për shkak të të ftohtit. Çdo njeri nuk ka nevojë të mendojë gjatë për të kuptuar se nuk është një rastësi që vetëm këto lloje që jetojnë në rajone të ftohta kanë këto tipare që i bëjnë të ndryshme nga fluturat e tjera. Mbijetesa e këtyre krijesave në vende të tilla na provon forcën e Allahut, i Cili na tregon në një ajet kuranor se Ai e di ku dhe si jetojnë gjithë krijesat:

Nuk ka asnjë krijesë në tokë që Allahu mos t'ia ketë garantuar furnizimin e saj. Ai e di ku jetojnë dhe vdesin. Ato janë të gjitha në një libër të qartë. (Hud: 6)

Tipare të tilla të gjallesave na bëjnë të mundur të kuptojmë fuqinë dhe forcën e Allahut dhe rrisin tek ne besimin dhe dashurinë për Të.



SÏ E GJEJNË SALMONËT RRUGËN E TYRE?

Ju gaboheni nëse mendoni që shtegtimi është karakteristikë vetëm e zogjve. Në fakt, ka shumë lloje shtegtarësh në tokë dhe det. Në këtë pjesë do të ndjekim aventurën e salmonit, peshkut shtegtar.

Salmonët vijnë në këtë botë duke dalë nga vezët që femrat kanë lëshuar në lumë. Ata rriten dhe qëndrojnë në këtë vend për javë të tëra, më pas nisin udhëtimin e tyre drejt detit. Pas një udhëtimi udhëtimi rraskapitës plot peripeci salmonët më në fund arrijnë në det të hapur ku kalojnë disa vite të jetës së tyre. Pasi rriten aq sa janë në gjendje të shumohen, ata kthehen përsëri në lumenj.





Destinacioni që salmonët duan të arrijnë është vendi ku kanë lindur, por largësia nuk është e shkurtër.

Distanca që peshqve u duhet të përshkojnë për të arritur në vendlindje mund të kapërcejë ndonjëherë edhe 1,500 km, që nënkupton një udhëtim prej disa muajsh. Ka shumë pengesa që salmonët duhet të kalojnë gjatë këtij udhëtimi.

Problemi i parë dhe ndoshta më i rëndësishmi është gjetja e grykëderdhjes së lumit, në të cilën peshku ka notuar gjatë udhëtimit të tij të parë për në det. Mbështetur te kjo, peshku do të përcaktojë rrugën e kthimit. Në mënyrë të habitshme, asnjë salmon nuk gabon dhe ata të gjithë e gjejnë lumin që me përpjekjen e parë.

Duke hyrë në lumë, salmoni fillon në mënyrë të vendosur të notojë kundër rrymës. Këtë herë detyra e tij është edhe më e vështirë sepse ndërsa herën e parë ka ndjekur me lehtësi rrymën duke notuar nën ujë, tani i duhet të ngjitet mbi ujëra. Gjatë këtij udhëtimi, salmoni mund të notojë në ujëra të cekëta që ia nxjerrin pendët e para mbi ujë. Këto ujëra të cekëta janë plot më zogj, arinj dhe shumë grabitqarë të tjerë.

Vështirësitë që salmoni duhet të kapërcejë nuk janë të kufizuara me kaq. Ai ka dalë nga një vezë në një degë lumi, në një pjesë në thellësi të tokës. Me qëllim që të arrijë përsëri atë pikë, kur lumi degëzohet, ai duhet të ndjekë pa u ngatërruar

rrugën e saktë. Salmoni nuk bën gabime në këto zgjedhje dhe ndjek gjithmonë të njëjtën rrjedhë.

Tani zëreni se ju keni lindur dhe jeni rritur në një shtëpi në një qytet! Një ditë ju largoheni nga shtëpia juaj, udhëtoni për ditë të tëra dhe arrini në një vend 1,500 km larg shtëpisë. Vitet kalojnë dhe ju dëshironi të ktheheni në vendin tuaj të lindjes. A mendoni se mund të jeni në gjendje të kujtoni rrugët që i keni kaluar vetëm një herë? Një qenie njerëzore nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, salmoni po. Ai e gjen gjithmonë rrugën e tij pa bërë asnjë gabim.

Janë bërë shumë studime për të kuptuar se si arrijnë salmonët të bëjnë këtë udhëtim të jashtëzakonshëm. Është arritur në përfundimin se salmonët gjejnë rrugën e tyre duke përdorur “nuhatjen”.

Në saje të nuhatjes se tij, një salmon mund të ndjekë një aromë





në ujë ashtu siç bën dhe një qen gjahu.

Çdo rrymë ka një aromë karakteristike. Salmoni i kujton të gjitha aromat gjatë udhëtimit të tij dhe kthehet në shtëpi duke i rikujtuar këto aroma.

Si mund të ndodhë një gjë kaq e jashtëzakonshme? Si mundet që çdo salmon të gjejë rrugën e tij në mënyrë kaq të përsosur? Pse të gjithë salmonët përpiqen të kthehen në vendin ku kanë dalë, duke rrezikuar jetën, duke kapërcyer ujëvara dhe duke u përballur me kafshë të egra? Për më tepër, ata nuk i bëjnë të gjitha këto për veten e tyre, por me qëllim që të lëshojnë vezët e tyre në këto ujëra.

Ka vetëm një përgjigje për këto pyetje: Allahu, i Gjithëdituri, e krijoi salmonin dhe sistemin që i bën të mundur atij të gjejë rrugën. Si të gjitha krijesat e tjera, salmoni vepron sipas



frymëzimit dhe instiktit të mësuar nga Zoti i Lartësuar.

Përmes provave që mohojnë teorinë e evolucionit është fakti se salmonët përshkojnë mijëra kilometra dhe rrezikojnë jetën e tyre për t'u shumuar. Evolucionistët deklarojnë se të gjitha krijesat janë në luftë me njëra-tjetrën dhe se vetëm më i forti mbijeton në fund të kësaj lufte. Megjithatë, në kundërshtim me pohimet e evolucionistëve, midis qenieve të gjalla ekziston një bashkëpunim i ngushtë. Kafshët rrezikojnë vetë jetën për pasardhësit e tyre. Përveç kësaj, siç do ta shikoni në shembujt që do të sillen më poshtë, ka lloje të ndryshme që bashkëpunojnë dhe përfitojnë nga njëri-tjetri. Salmoni është një nga krijesat më interesante që shfaq sjelljen e tij vetëflijuese për pasardhësit e vet. Salmonët shtegtojnë dhe kujdesen të arrijnë vendlindjen për t'u shumuar. Ata mbeten të pakët në numër dhe ngordhin shpejt pasi lëshojnë vezët e tyre. Megjithatë, ata nuk heqin dorë nga udhëtimi i tyre. Një sjellje e tillë nuk mundet të shpjegohet nga teoria e evolucionit. Ky fakt është shumë i qartë. Allahu krijoi salmonin dhe këto krijesa sillen siç i frymëzoi Ai. Njerëzit që përdorin urtësinë e tyre mund të marrin mësim nga sjelljet e kafshëve të tilla. Allahu u kujton atyre:

Të gjitha krijesat janë nën sundimin e Tij ... (Hud: 56)





40

SI JETOJNË PESHQIT NË UJË?

Ju duhet të keni parë se sa të shpejtë dhe të shkathët janë peshqit në ujë. Me qëllim që të notojë, një peshk nuk ka nevojë të bëjë asnjë lëvizje tjetër veçse të tundë bishtin e tij nga njëra anë në tjetrën. Kjo lëvizje e lehtë e peshqve ndodh në saje të shtyllës së tyre kurrizore elastike, si dhe në saje të disa sistemeve të tjera në organizmin e tyre.

Një peshk, kur noton, harxhon një sasi të madhe energjie. Peshkut i nevojiten sasi të mëdha energjie me qëllim që të arrijë shpejtësi të larta. Është e nevojshme për një peshk të fitojë shpejtësi në mënyrë të menjëherëshme për t'u shpëtuar grabitqarëve.

Për më tepër, peshku lëviz kundër rrymës pothuajse në pjesën më të madhe të kohës. Merrni me mend se sa e vështirë është për ju të lëvizni nën ujë dhe sa e lehtë është të ecni në rrugë. Krahasoni jetën nën ujë dhe jetën në tokë.

Është ndërtimi i veçantë i



KRIJESA TË MREKULLUESHME





shtyllës kurrizore dhe muskujve të peshkut që siguron një fuqi të tillë. Shtylla kurrizore mban trupin drejt dhe është e lidhur me fletët dhe muskujt e peshkut. Përndryshe, nuk do të ishte e mundur për peshkun të lëvizte nën ujë. Megjithatë, forma e veçantë e shtyllës kurrizore nuk është e mjaftueshme për peshkun që të notojë, sepse peshku nuk lëviz vetëm përpara dhe prapa, por edhe lart e poshtë me qëllim që të mbijetojë. Kjo lëvizje bëhet e mundur nga një sistem në trupin e tyre. Peshqit kanë qese ajri në trupat e tyre. Duke boshatisur këto qese ajri, peshku mund të zbresë në fund të detit dhe, duke rimbushur këto qese me ajër, mund të ngrihet në sipërfaqe përsëri.

A keni pyetur ndonjëherë veten se si peshqit nuk dëmtohen fare, edhe pse ndodhen gjithë kohën në ujë? Lëkura ndikohet

Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës dhe të ditës, në anijen që lundron në det dhe u sjell dobi njerëzve, në shiun që lëshon Allahu nga lart, me të cilin ngjall tokën e vdekur dhe përhap në të nga çdo gjallesë, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit dhe tokës (në të gjitha këto) ka argumente për një popull që mendon.

(El-Bekare: 164)

nga uji nëse qëndrojmë në ujë qoftë edhe pak. Nëse qëndrojmë për një kohë më të gjatë, lëkura jonë mund të dëmtohet. Peshkut kjo nuk i ndodh kurrë në saje të një shtrese të papërshkueshme në lëkurën e tij të jashtme. Kjo shtresë ndalon ujin të hyjë në trupin e tij. Nëse peshqit nuk do ta kishin këtë shtresë, trupat e tyre do të dëmtoheshin e nëse uji do t'u futej në trup, ekuilibri do të prishej dhe ata do të



ngordhnin. Megjithatë, kjo nuk ndodh dhe të gjithë peshqit vazhdojnë të jetojnë nën ujë.

Të gjitha llojet e peshqve në botë kanë këto tipare. Llojet që kanë jetuar më parë i kanë pasur, gjithashtu, këto tipare. Peshqit kanë pasur të njëjtën strukturë të përsosur për miliona vjet pa asnjë ndryshim. Është e mundur të shihet kjo gjë në mbetjet fosile të peshqve që kanë jetuar miliona vite më parë. Këto mbetje fosile tregojnë në mënyrë shumë të qartë se peshqit kanë qenë të njëjtë, sikurse janë edhe sot dhe nuk kanë ndryshuar aspak. Kjo është një provë që të gjitha llojet e peshqve kanë ardhur në këtë botë në një kohë, në një çast të vetëm. Me fjalë të tjera, ata janë krijuar. Është Allahu Ai që u ka dhënë peshqve të gjitha tiparet që kanë dhe krijoj gjithçka në gjithësi. Ai i njuh të gjitha nevojat e të gjitha krijesave.



Fotoja në të majtë tregon mbeturinat, ose fosilin e një peshku që jetonte shumë kohë më parë. Një anëtar tjetër i së njëjtës familje peshqish, që jeton edhe sot, mund të shihet në figurën më poshtë. Siç e shihni, nuk ka asnjë ndryshim mes tyre.

A KANË PAPAGAJTË NJOHURË MBI KIMINË?

Disa bimë kanë fara helmuese. Kjo është një metodë e efektshme për t'u mbrojtur nga gjallesat që përpiqen për t'u ushqyer me to. Mirëpo një lloj papagalli që jeton në Amerikë mund të ushqehet me këto fara helmuese. Kjo është shumë e çuditshme, sepse ndërsa krijesa të tjera nuk mundën as t'u afrohen këtyre bimëve, këta zogj që vazhdimisht ushqehen me këto bimë nuk ndikohen aspak. Ju jeni kureshtarë të dini se si ndodh kjo, apo jo?

Fakti se ky lloj papagalli, i quajtur makau, nuk helmohet nga bimë të tilla ka tërhequr edhe vëmendjen e shkencëtarëve. Ata kanë vëzhguar papagajtë makau dhe kanë qenë dëshmitarë të një mënyre të jashtëzakonshme përshtatjeje.

Pasi ushqehen me këto fara helmuese, papagajtë makau fluturojnë drejt një vendi shkëmbor. Atje ata brejnë shkëmbin dhe hanë pak argjilë që përmban edhe gurishte. Kjo nuk është një sjellje e zakonshme. Në të vërtetë, gurishtet që ndodhen në argjilë tresin helmin e farave. Kështu, këta papagaj mund të bluajnë farat pa pësuar asgjë.






Ju keni lexuar se papagalli makau ushqehet në shkëmbinj që përmbajnë argjilë, siç shikohet dhe në figurë. Nëse do ta shihnit këtë figurë pa lexuar librin, atëherë sjellja e papagallit do t'ju çudiste. Ndoshta nuk do ta kishit kuptuar se çfarë po bëjnë papagajtë. Tani e dini pse ata hanë argjilë. Me e rëndësishmja është se ju e dini që Allahu i mëson ata të veprojnë kështu.

Si është e mundur që ky zog zotëron njohuri të tilla për të mënjanuar efektin helmues të farës? Si mund të dijë ai se si mënjanohet ndikimi i helmit? A është e mundur që ai ta ketë zbuluar vetë se substanca që neutralizon ndikimin e helmit gjendet në shkëmbinjtë që përmbajnë argjilë? Patjetër që jo.

Një njeri nuk mund të kuptojë nëse një farë është helmuse apo jo vetëm nëpërmjet shikimit. Ai nuk është në gjendje të zbulojë si të neutralizojë ndikimin e helmit, pa u konsultuar me njerëzit kompetentë në këtë fushë. Në këtë rast, nuk mund të thuhet që një zog pa aftësi mendore mund të ketë zbuluar një gjë të tillë pas disa analizave dhe studimeve kimike të zgjata. Nuk është e mundur për papagajtë makau të kenë fituar rastësisht njohuri të tilla, të cilat mund të mësohen nga qeniet njerëzore vetëm pas disa vitesh arsimimi. I Gjithëdituri që krijoi gjithçka në mënyrë të përsosur, ua mësoi këtyre zogjve këtë instikt.



***A nuk menduan ata rreth vetes së tyre?
Allahu nuk i krijoi qiejt e tokën dhe çdo gjë
që gjendet ndërmjet tyre pa ndonjë qëllim të
caktuar dhe për një kohë të kufizuar. Por një
pjesë e mirë e njerëzve e mohojnë takimin
me Zotin e tyre. (Er-Rum: 8)***



MJESHTËRIA INXHINIERIKE NË PËLHURËN E MERIMANGËS

A e keni vënë re ndonjëherë rrytën e merimangës? A e dini se si e prodhojnë merimangat fillin e tyre dhe se ç'karakteristika mahnitëse ka ky fill? A keni dëgjuar se teknika e përdorur nga merimangat për të thurur pëlhurën është e njëjtë me atë që përdorin sot inxhinierët?

Një merimange i nevojiten dy vende të ndara me qëllim që të thurë pëlhurën e saj. Pëlhurat, zakonisht, janë të thurura në kënde, aty ku dy mure bashkohen ose ndërmjet dy degëve. Megjithatë, disa merimanga janë aq të afta, sa të thurin pëlhurën e tyre duke përdorur një sipërfaqe të vetme. Mënyra se si merimanga e thur pëlhurën e saj është e mrekullueshme. Përpiquni të përfytyroni çfarë do t'ju tregojmë më poshtë.

Merimanga, si fillim, gjen një degë elastike që është e gjatë në mënyrë të mjaftueshme për të thurur pëlhurën e saj. Pastaj ajo fikson dhe ngjit një fije në fund të degës. Duke lëvizur poshtë degës, ajo vazhdon të sekretojë fije të shumta. Në çastin që përshkon një distancë të caktuar, ajo ndalon dhe pushon se sekretuari. Tërheq fijet që ka sekretuar, i lakon si një hark dhe i ngjit me pikën fillestare. Pastaj fillon të thurë pëlhurën e saj përbrenda këtij harku.







Tani mendoni çfarë do të bënit sikur t'ju duhej të tendosnit një spango dy metra e gjysmë të gjatë ndërmjet dy mureve që janë dy metra larg njëri-tjetrit. Ndërsa jeni duke u përpjekur ta gjeni, na lejoni t'ju shpjegojmë se si e zgjidh merimanga këtë problem.

Merimangat e kopshtit e thurin pëlhurën e tyre disa herë ndërmjet dy degëve që janë larg njëra-tjetrës. Meqenëse pëlhura të tilla janë shumë të mëdha, ato kanë mundësi më të mëdha për të zënë gjahun. Megjithatë, masa e tyre e madhe bëhet shkak për pakësimin gradual të tendosjes së rrjetës, që do të thotë rënie në aftësinë për të zënë gjahun. Kështu që merimangave u duhet një zgjidhje. Ju mund të keni menduar se merimanga do të thurë një rrjetë të re, pasi rrjeta ekzistuese nuk është më e tendosur sa duhet. Mirëpo në vend që të zëvendësojë rrjetën, merimanga bën diçka të mrekullueshme: sekretin një fije nga qendra e rrjetës poshtë në tokë dhe fikson një gur të vogël në fund të fijes që është pranë tokës. Duke u kthyer tek rrjeta dhe duke e tërhequr fijen, ngre gurin. Pastaj lidh edhe një herë në qendër të rrjetës fijen, në fundin e së cilës guri lëkundet në ajër. Si rezultat, rrjeta tendoset përsëri, ndërsa pesha e gurit të varur e tërheq atë poshtë.

Ju, sikurse shumë njerëz që nuk kanë njohuri nga ndërtimi, nuk do të arrinit të mendonit për një zgjidhje të tillë. Megjithatë, merimangat e njohin dhe e zbatojnë këtë teknikë. Si është e mundur që një merimangë të njohë një teknikë kaq të mrekullueshme dhe ta zbatojë atë aq mirë? Për më tepër, çdo





merimangë ka thurur rrjetën e saj duke zbatuar të njëjtën teknikë për shumë vjet me radhë. Këtu nevojitet të ekzistojë një Forcë që frymëzon merimangën të përdorë këtë teknikë, sepse fuqia për ta bërë këtë nuk i përket vetë merimangës. Kjo Forcë i takon Allahut të Gjithëfuqishëm, Zotit të gjithësisë, që drejton dhe frymëzon të gjitha krijesat e gjalla.

NJË KRIJESË ÌNTERESANTE: NAUTILUS

Ju mund të keni parë nëndetëse në TV ose në revista. Ato janë të afta të veprojnë në thellësi të detit pa u vënë re dhe përdoren për sigurinë kombëtare apo për kërkime shkencore. Nëndetësët punojnë kështu: ndërsa rezervuarët e posaçëm të zhytjes në një nëndetëse janë të mbushur me ujë, anija bëhet më e rëndë se uji dhe zhytet poshtë në oqean. Nëse nuk ka ujë në rezervuare dhe ato mbushen me ajër, nëndetësja ngrihet përsëri në sipërfaqen e ujit.

Tani le të analizojmë nautilusin, një krijesë shumë interesante që përdor të njëjtën teknikë. Nautilusi ka një guaskë spirale dhe zhytet si një nëndetëse. Ka një organ të modeluar si një guaskë kërmilli me diametër 9 cm, siç tregohet edhe në figurë.




Ky organ përmban 28 "dhoma zhytjeje" të ndërlidhura. Këto dhoma zhytjeje funksionojnë në të njëjtën mënyrë si dhe rezervuaret në një nëndetëse; me fjalë të tjera, nautilusit i nevojitet ajër i ngjeshur. Në nëndetëse, kjo arrihet nga një sistem i veçantë, i ndërtuar nga inxhinierët që vendoset në vendet përkatëse të nëndetëses. Po si mundet nautilusi të sigurojë ajrin e ngjeshur, të nevojshëm për të nxjerrë ujin jashtë?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje na njeh me një tjetër tipar të mrekullueshëm të nautilusit. Një gaz i veçantë prodhohet në trupin e tij. Ky gaz transferohet nëpër dhoma përmes qarkullimit të gjakut dhe në të njëjtën kohë largon ujin nga qelizat. Kështu, një nautilus mund të zhytet në thellësi ose të lundrojë për të mbrojtur veten e tij nga grabitqarë të tjerë ndërsa gjuan. Në fakt, kufiri i zhytjes i nautilusit është më i madh se i një nëndetëseje. Një nëndetëse mund të zhytet deri në 400 metra, ndërsa për një nautilus është shumë e lehtë të zhytet deri në 4,000 metra.

Krijimi i këtij sistemi të veçantë të kjo gjallesë, duhet të na

Ju mund të vini re se nuk ka asnjë ndryshim midis një fosili të nautilusit të shumë kohëve me parë (figura më poshtë) dhe atij që jeton sot, apo jo?





... Dija e Zotit tim ka përfshirë çdo gjë. A nuk i kushtoni vëmendje? (El-En'am: 80)

nxisë të mendojmë. A mundet një nautilus ta ketë fituar atë rastësisht? A mundet ai ta ketë përshtatur vetë këtë ndërtim të trupit të tij që bën të mundur prodhimin e gazit?

Për më tepër, ajo çka pamë deri tani nuk është e vetmja veçori mahnitëse e nautilusit. Trysnia nën ujë është mjaft e madhe. Kjo është arsyeja, për të cilën ndjejmë shtypje në veshët tanë kur zhytemi thellë në ujë. Ndërsa njeriu fillon të zhytet në ujë, trysnia rritet dhe pas një thellësie të caktuar, ajo ka ndikim vdekjeprurës për qeniet e gjalla. Megjithatë, edhe pse është vetëm një krijesë e vogël dhe ka vetëm një guaskë të jashtme për t'u mbrojtur, nautilusi nuk ndikohet nga kjo tryzni, që mund të arrijë në kufij ekstremë.

Është e qartë se të gjitha këto veçori të nautilusit janë të krijuara. Kjo gjallesë nuk mund ta ndërtojë vetë strukturën e trupit për të prodhuar gazin e nevojshëm për t'u ngritur në sipërfaqe apo për t'i bërë ballë trysnisë së ujit. Allahu, i Cili është Krijuesi i gjithçkaje në mënyrë të përsosur, ka krijuar edhe këtë strukturë të mrekullueshme. Në një ajet të Kuranit, Allahu fton njerëzit që të mendojnë:

A është Ai që krijon i barabartë me atë që nuk krijon?! A nuk mendoni?! (En-Nahl: 17)



FLUTURAT QË KANË NJOHURË RRETH FIZIKËS

Pamja e jashtme e fluturës është e admirueshme. Këto krijesa, me krahët e tyre shumëngjyrësh dhe fluturimin elegant, janë disa nga bukuritë që Allahu ka krijuar për ne. Megjithatë, pamja e mrekullueshme nuk është veçoria e vetme e fluturave. Kjo gjallesë jetëshkurtër është në gjendje të bëjë llogaritje siç bën një specialist. P.sh., ashtu si dhe fluturat e dimrit për të cilat folëm pak më parë, ngrohtësia e trupit të fluturave

duhet të jetë në një temperaturë të caktuar në mënyrë që ato të fluturojnë. Të shohim se çfarë bëjnë fluturat për të zgjidhur këtë problem.



Fluturat kolias nuk mund të fluturojnë kur temperatura e trupit të tyre është poshtë 28°C. Në raste të tilla flutura hap krahët e saj për të ekspozuar pjesën e brendshme në diell me qëllim që rrezet e diellit të bien në një kënd të caktuar. Nëse temperatura e trupit rritet deri në 40°C (104°F), flutura rrotullohet 90 gradë duke ulur në minimum sasinë e nxehtësisë që thith trupi i saj, ndaj dhe temperatura e trupit të saj ulet.

Përveç kësaj, kjo flutur ka njolla të vogla të zeza në krahët e saj. Këto njolla, funksioni i të cilave është mbajtja e trupit në temperaturë të lartë,





janë të vendosura në vende të caktuara. Ato janë afër atyre pjesëve që duhet të jenë të ngrohta. Në saje të këtij ndërtimi të veçantë, transmetimi i nxehtësisë nga këto njolla, që nxehen shpejt, në pjesët e tjera të trupit lehtësohet nga largësia e shkurtër.

Një tjetër lloj fluturë përdor të njëjtën metodë për rritjen e temperaturës së trupit të saj. Ju të gjithë e dini se çfarë është një lente. Disa përdoren për të zmadhuar një objekt kurse disa të tjera për të zvogëluar. Për shembull syzet përbëhen nga dy lente. Përveç këtij funksioni, një lente e vendosur në mënyrë të saktë në drejtim të diellit mund të përqendrojë rrezet e diellit në një pikë të caktuar. Duke përdorur këtë metodë është e mundur madje të ndizet flaka. Pieris, një lloj tjetër fluturë, ekspozon krahët e saj në drejtim të diellit kështu që të gjitha rrezet depërtojnë në pjesë të veçanta të trupit të saj që kanë nevojë të ngrohen, duke përdorur të njëjtin parim me atë të lenteve.

Natyrisht që këto flutura nuk janë arsimuar në fizikë apo në ndonjë fushë tjetër. Ato nuk mund t'i njohin veçoritë e lenteve. Ato nuk mund të dinë se cili kënd mund të marrë nxehtësinë





më të madhe. Allahu, i Cili shikon dhe mbron çdo gjë, i frymëzon fluturat se çfarë të bëjnë për të rregulluar temperaturën e trupit të tyre. Në një ajet të Kuranit thuhet:

... Allahu është mbikqyrës mbi çdo gjë. (El-Ahzab: 52)

PESHKU MACE NË DETYRË

Shumëkush nuk e di se peshqit ndërtojnë fole dhe sigurojnë mbrojtje për të vegjlit e tyre vazhdimisht. Këto fole, zakonisht, janë vrime në formacione gurësh ose në rërë. Vezët qëndrojnë në këto fole të hapura për disa kohë, ndërsa nëna dhe babai vëzhgojnë me radhë vezët për t'i mbrojtur nga grabitqarët.


Peshqit mace janë ndër ato krijesa që mbrojnë të vegjlit e tyre. Peshku mace femër lëshon vezë në fund të bimëve dhe kallamave në ujërat e cekëta. Vezët ngjiten pas rrënjëve të këtyre bimëve. Pas disa minutash, femra largohet nga vezët dhe është radha e mashkullit të marrë detyrën. Detyra e mashkullit është të qëndrojë pranë vezëve dhe t'i ruajë nga rreziku. Kjo detyrë zgjat për afro 40-50 ditë, derisa peshqit e vegjël të rriten.

Përveç kësaj vigjilence, mashkulli lëshon edhe një tingull gurgullime duke përdorur gushën e tij. Në këtë mënyrë ai mban larg vezëve peshqit e tjerë grabitqarë. Ai e di që ky



tingull i frikëson peshqit e tjerë dhe i detyron ata të largohen.

Allahu i frymëzon peshqit mace të mbrojnë të vegjlit e tyre në këtë mënyrë. Si të gjitha krijesat e tjera, ky lloj peshku vepron sipas instikteve që Allahu ka vendosur tek ai.




ÇFARË DINI PËR KRIJESAT LUMINISHENTE (DRITË-PRODHUËSE)?

Keni parë ndonjëherë disa drita të vogla që lëvizin natën nëpër pemë? Burimi i këtyre dritave, që nganjëherë mund të jenë aq shumë sa që një pemë mund të jetë e mbushur me to, janë xixëllonjat. Ato janë krijesat luminishente më të njohura. Këto krijesa, të cilat me dritën e tyre ndriçojnë pemët në errësirë, janë ndër krijesat që shkencëtarët kanë studiuar më shumë. Para se të analizojmë arsyet, do të shohim se si e përdorin dritën këto krijesa.

Xixëllonjat prodhojnë në trupat e tyre dritë të gjelbër në të verdhë. Drita është për xixëllonjat një mjet

komunikimi. Kjo dritë përdoret edhe për t'u mbrojtur nga armiqtë.



Shkencëtarët janë përpjekur me vite të tëra për të imituar dritën që prodhohet nga xixëllonjat, por megjithatë nuk kanë pasur sukses. Kjo është një nga provat se Allahu krijoi xixëllonjat në mënyrë të përkryer.



Me metodën e dritës armiqtë e tyre kuptojnë se xixëllonjat nuk janë të shijshme dhe kështu vendosin të mos ushqehen me to.

Karakteristika kryesore e këtyre insekteve është se ato nuk humbasin energji kur prodhojnë këtë dritë. Për këtë arsye, xixëllonjat kanë qenë objekt kërkimesh për shkencëtarët për vite me radhë. Megjithatë, njerëzit nuk kanë arritur ende të prodhojnë një dritë si ajo e xixëllonjave.


Është e habitshme se si një gjallesë prodhon dritë pa nxehtësi. Ju mund ta keni vënë re që llambat prodhojnë nxehtësi, ashtu si edhe dritë. Nëse ju prekni një burim drite, p.sh. një llambë, do të shihni që ajo është shumë e nxehtë. Nxehtësia që xixëllonjat prodhojnë nuk ndikon mbi to. Kjo ndodh sepse drita e prodhuar prej tyre është tërësisht e ndryshme nga ajo që ne përdorim si mjet ndriçimi. Kjo dritë është quajtur "drita e ftohtë" dhe gjatë prodhimit të kësaj drite nuk lëshohet nxehtësi. Me fjalë të tjera, prodhimi i kësaj drite kërkon sasinë minimale të energjisë. Si rrjedhim, prodhimi i kësaj drite është shumë i efektshëm dhe shkencëtarët janë përpjekur për vite me radhë ta imitojnë.

Ashtu si xixëllonjat, krijesa të ndryshme nënujore, insekte dhe lloje të tjera gjallesash prodhojnë dritën e tyre. Secili ka mënyrën e vet të prodhimit të dritës apo të përdorimit të saj. Secili është një mrekulli në vetvete.

Është e qartë se gjallesat nuk janë vetëpajisur me sistemet e prodhimit të dritës. Një sistem që prodhon dritë në trupin e

60

KRIJESA TË MREKULLUESHME



krijesave të gjalla nuk mund të vijë në jetë si rezultat i rastësisë. Për më tepër, një strukturë kaq e përsosur që nuk shkakton dëme në trup nuk mund të jetë shfaqur gjatë procesit të prodhimit. Krijesat luminishente janë një provë e qartë e fuqisë së Allahut, i Cili na demonstroi dijen, mençurinë dhe fuqinë nëpërmjet krijimit të tyre.

KRIJESAT LUMINISHENTE NËNUJORE

Shumë qenie nënujore, si ajo që shihni në foto, janë të pajisura ashtu si xixëllonja me një sistem të veçantë për prodhimin e dritës. Ato zakonisht e përdorin dritën për të hutuar ose frikësuar armiqtë e tyre. Shumica e tyre kanë një radhë qelizash përgjatë kurrizit, të cilat mund të prodhojnë dritë. Tani le të shohim karakteristikat e përgjithshme të këtyre krijesave.

Një nga këto gjallesa është dhe një kafshë që ngjan me kandilin e detit. Ato zakonisht ushqehen me gjallesa dhe bimë detare mikroskopike që janë të padukshme për syrin e lirë. Disa e kapin gjahun duke përdorur tentakulat e tyre ngjitëse që lëvizin




në ujë si një fill. Disa lloje të tjera kanë gojë të madhe me të cilën mund të gëlltisnin shumë gjallesa të tjera. Ato kanë qime të holla mbi trupat e tyre, të cilat i përdorin për të lëvizur nëpër ujë.

Krijesat luminishente kanë disa karakteristika të tjera të mrekullueshme. P.sh., disa specie me ngjyrë të kuqe ndriçojnë kur zbulohen dhe mund të lënë një dritë vezulluese në ujë. Kjo është një mënyrë për të ngatërruar armiqtë e tyre dhe kështu të shpëtojnë.

Krijesat si ylli i detit dhe yjet pupël janë "gjembaçë". Ato janë të mbuluara me gjemba, të cilat i përdorin si mjet mbrojtjeje. Ato jetojnë në breg të detit, në korale nënujore dhe në fund të detit. Këto krijesa, gjithashtu, prodhojnë dritë për t'u mbrojtur nga armiqtë.

Tipari më interesant i gjallesave luminishente detare është se



Atij i përket ç'ka në qiej dhe në tokë. Të gjithë vetëm atij i përulen. Është Ai që e fillon krijimin e jetës dhe pastaj e përsërit atë. Ajo është dhe më e lehtë për Të.

(Er-Rum: 26-27)



ato e përdorin dritën e tyre për të çorientuar të tjerët. Një yll deti është një shembull për këtë. Yjet e detit jetojnë në rreth 1000 metra thellësi në det. Nga krahët e tyre lëshojnë dritë blu në të gjelbër. Ky paralajmërim vezullues i vë në dijeni armiqtë se kjo gjallesë nuk është e shijshme. Një lloj tjetër yjesh deti fillojnë të vezullojnë kur sulmohen. Ata shkëputen dhe hedhin dritë nga krahët e tyre në drejtim të armikut për ta çorientuar. Vëmendja e armikut zhvendoset në drejtim të dritës. Në të njëjtën kohë, ylli i detit gjen kohë për t'u larguar.

Sikurse e pamë edhe në shembujt e dhënë më lart, mekanizmi që bën të mundur prodhimin e dritës në këto krijesa tregon edhe një herë krijimin e përkryer të Allahut. Krijesat që janë përmendur këtu nuk mund të kenë inteligjencë si ajo e qenieve njerëzore. Megjithatë, secila prej tyre ka tipare të tilla të mrekullueshme që na mahnisin. Këta shembuj na ndihmojnë të kuptojmë forcën krijuese të Allahut të Madhëruar.



Allahu na informon në një ajet kuranor se ata që guxojnë të adhurojnë dikë tjetër në vend të Tij, do të jenë prej të braktisurve:

Mos i shoqëro Allahut askënd në adhurim, përndryshe do të jesh i qortuar dhe i braktisur. (El-Isra': 22)

ÇANTA E FJETJES SË PESHKUT PAPAGALL

Peshku i paraqitur në foto quhet peshku papagall, pasi, siç mund ta vini re edhe ju, i ngjan papagallit. Ky peshk shumëngjyrësh përdor një metodë të pazakontë për të mbrojtur veten e tij prej armiqve. Veçanërisht natën, ai e mbulon gjithë trupin me një lëndë xhelatinoze që e prodhon vetë. Përpara se të shpjegojmë shkakun, le të shohim si prodhohet dhe si përdoret kjo lëndë.

Kjo masë xhelatinoze prodhohet nga pjesa e brendshme e zgavrës së gushës së peshkut papagall. Ai e sekreton lëndën ndërsa merr frymë. Pas pak, kjo cipë mbulon tërësisht trupin e peshkut. Duke vepruar kështu, peshku e vendos veten e tij në një lloj çante gjumi dhe mbrohet nga rreziqet e jashtme gjatë natës. Kjo lëndë bën të mundur që peshku të fshihet duke u maskuar. Si një funksion jetik, kjo çantë fjetjeje mbron peshkun

65

KRIJESATË MREKULLUESHME

Në figurën më poshtë
paraqiten çantat e fjet-
jes që mbrojnë pesh-
qit papagaj.





nga ngjالات morej, një nga armiqtë më të rrezikshëm për të. Kjo ngjalë zotëron një shqisë nuhatjeje të shkëlqyer dhe mund ta gjejë gjahun nëpërmjet saj. Megjithatë, cipa mbrojtëse e peshkut papagall e pengon ngjalën të nuhasë erën e tij. Ngjala morej nuk mund ta dallojë peshkun brenda cipës edhe nëse përplasat me të kur kalon pranë tij.

Nga kjo, mund të shtrohet pyetja e mëposhtme: Si është e mundur që peshku papagall mban këtë cipë mbrojtëse që e përdor natën? Si mund ta dinë këta peshq që armiqtë e tyre gjuajnë nëpërmjet shqisë së nuhatjes? Si e zbuluan këtë lëndë kaq thelbësore në bllokimin e nuhatjes së ngjalës që bën të mundur të kalojnë natën në mënyrë të sigurtë?

Është e qartë se nuk mund të mendohet që një peshk të vendosë të prodhojë një lëndë kimike në trupin e tij dhe pastaj të mbulohet me të. Njëkohësisht, një gjë e tillë nuk mund të zhvillohet në mënyrë të rastësishme. Peshku papagall, paraqitur edhe në figurë, nuk mund të planifikojë në mënyrë të vetëdijshme prodhimin e kësaj lënde; as edhe një peshk papagall që ka jetuar 1000 apo 10000 vjet më parë nuk ka qenë në gjendje...

Është mëse e qartë se një tipar i tillë mund të vijë vetëm si rezultat i një procesi inteligjent: krijimit.





AFTËSIA MASKUESE E PESHKUT AKREP

Pamja e jashtme e peshkut akrep është shumëngjyrëshe. Këta peshq kanë ngjyrë të njëjtë me koralet ku jetojnë. Siç e shihni në foto, peshku akrep me vija të bardha e të kuqe, mund të fshihet duke u maskuar midis koraleve, të cilat kanë të njëjtat ngjyra. Në këtë mënyrë, ai i shpëton vëmendjes së grabitqarëve. Gjithashtu, në saje të kësaj përshtatjeje me koralet, ai mund të tërheqë me lehtësi edhe gjahun e vet.

Shikoni me kujdes peshkun akrep (në figurën poshtë dhe në figurën në faqen tjetër) dhe do të kuptoni se sa e vështirë është që të vësh re praninë e tij në mjediset korale.





Në saje të larmisë
së ngjyrave të
veçanta, peshku
akrep fshihet
shumë lehtë
nëpër shkëmbinj.



Si peshku akrep, edhe shumë gjallesa të tjera detare nuk mund të dallohen për shkak të përshtatjes me mjedisin ku jetojnë. Prania e tyre mund të vihet re vetëm kur ato lëvizin. Këto krijesa përdorin shumëngjyrshmërinë e tyre për të gjuajtur, për t'u riprodhuar dhe për t'u dhënë sinjale të ndryshme krijesave të tjera. Po si vjen kjo harmoni? Kush e bëri ngjyrën e peshkut të njëjtë me shkëmbinjtë nënujorë?

As rastësia dhe as veprimi i peshqve të tjerë nuk mund t'i japë një krijese ngjyrën e mjedisit ku jeton. Një peshk, një karkalec ose një gaforre nuk mund të ketë njohuri mbi ngjyrat, as të jetë në gjendje të prodhojë një sistem për të ndryshuar ngjyrat në trupin e tij. Sisteme të tilla mund të përcaktohen dhe të vendosen në trupat e kafshëve nga një forcë e mbinatyrshme.

Kjo forcë është Allahu i Plotfuqishëm. Ai i ka krijuar të gjitha krijesat bashkë me tiparet që ato zotërojnë në harmoni me mjedisin ku ato jetojnë. Allahu na bën të ditur në Kuran:

Si është e mundur që Allahu të mos dijë atë që ata fshehin apo punojnë hapur, kur dihet fare mirë se Ai është Krijuesi i gjithçkaje dhe njeh me hollësi çdo gjë që kanë në zemër. Allahu është Ai që e bëri tokën për ju të përshtatshme për të jetuar, prandaj ecni nëpër rrugët e saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij. S'ka dyshim se tek Ai do të ktheheni pasi të ringjalleni. (El-Mulk: 14-15)

TËPARET ÌNTERESANTE TË KUAJVE TË DETIT

Ju mund të keni parë kuaj deti në televizion ose në libra. Pamja e tyre jo e zakonshme dhe forma valëvitese e notimit mund të ketë tërhequr vëmendjen tuaj. A e dini që, ndryshe nga sa mund të supozohet, këto kafshë janë shumë të vogla? Kuajt e detit, që janë të madhësisë 4 deri 30 cm, zakonisht jetojnë nëpër leshterikë dhe bimë të tjera afër bregdetit. Mburoja kockore e kalit të detit e mbron atë nga rreziqet. Kjo mburojë është aq e fortë, saqë është e pamundur ta thyeni me duart tuaja.

Koka e kalit të detit është në të djathtë të trupit të tij. Kjo nuk vihet re në asnjë peshk tjetër. Si rrjedhim, kuajt e detit notojnë me trupin e tyre vertikalisht dhe lëvizin kokën e tyre lart dhe poshtë. Megjithatë, ata nuk mund t'i kthejnë kokat e tyre anash. Mund të merret lehtë me mend sa probleme do të kishin krijesat e tjera nëse nuk do të kishin mundësi të kthenin kokat në të djathtë ose




Kuajt e detit dhe pasardhësit e tyre.



të majtë. Megjithatë, në saje të ndërtimit të veçantë të trupit të tyre, kuajve të detit nuk u ndodhin probleme të tilla. Secili sy i kuajve të detit mund të lëvizë individualisht dhe lirshëm në të gjitha drejtimet. Kështu, kuajt e detit shikojnë rreth tyre lehtësisht, edhe pse nuk mund të kthejnë kokat anash.

Do të ishte mjaft interesante të studionim nga afër mënyrën e lëvizjes së kuajve të detit në ujë, pasi ata notojnë në saje të një sistemi plotësisht të veçantë. Kali i detit ka një numër fshikëzash notimi. Me sasinë e nevojshme të gazit që mbush këto fshikëza, një kalë deti mund të notojë lart dhe poshtë. Nëse këto fshikëza do të dëmtoheshin apo sikur një sasi e vogël e gazit të mungonte, kuajt e detit do të fundoseshin, pra do të ngordhin. Duhet të vërejmë se sasia e gazit që mbush fshikëzat e notimit është e ndarë në mënyrë të përsosur. Si pasojë, një ndryshim sado i vogël mund të çojë në ngordhjen e gjallesës.

Ky organizim i përsosur ka rëndësi të madhe. Nëse kuajt e detit mund të mbijetojnë vetëm në saje të një sasive të caktuar gazi në fshikëza, atëherë ata duhet t'i kenë pasur tiparet që i kanë sot që në çastin kur janë shfaqur. Me fjalë të tjera, kuajt e detit nuk i kanë fituar këto tipare me kalimin e kohës, siç pohojnë evolucionistët. Ata janë krijuar së bashku me të gjitha tiparet dhe karakteristikat. Si gjithë krijesat e tjera në



gjithësi, Allahu i ka krijuar kuajt e detit në mënyrë të përsosur.

Krijimi i këtyre peshqve, të cilët janë vetëm një nga llojet e shumta të krijesave detare, është një shembull i fuqisë dhe dijes së pafundme të Allahut.

PILIVESAT: MAKINAT FLUTURUESE

Në vendet ku ka ujë, është e mundur të shohësh pilivesat. Nëse e njihni këtë insekt, ju mund të keni parë që ai lëviz shumë shpejt dhe mund të bëjë lëvizje shumë të papritura në të gjitha drejtimet.

Pamja e pilivesave i ngjan një helikopteri. Ky insekt ka një aftësi të jashtëzakonshme për të fluturuar. Pavarësisht nga shpejtësia dhe drejtimi, këto insekte mund të ndalojnë në çast dhe të fluturojnë në drejtim të kundërt, mund të qëndrojnë pezull në ajër dhe të presin çastin e përshtatshëm për të zënë gjahun e tyre. Kjo është e mundur në saje të krahëve të tyre, që mund të rrahin shumë shpejt. Kur janë në një pozicion të caktuar, ato mund të bëjnë një kthim të shpejtë dhe të drejtohen drejt gjahut të tyre. Në fakt, këto janë vetëm pak aspekte të manovrave të pilivesave që kanë qenë burimi i frymëzimit për njerëzimin në ndërtimin e helikopterëve.

Një pilivesë, ngjyrat e së cilës mund të ndryshojnë nga e kaltër



e hapur në vishnje, ka dy çifte krahësh në kurrizin e saj. Njëri është përballë dhe tjetri prapa. Gjatë fluturimit, dy krahët e përparmë lëvizin lart kurse dy krahët e prapmë lëvizin poshtë.

Helikopterët "Sikorski" janë prodhuar me teknologjinë e sotme duke marrë për bazë formën e krahëve të pilivesës. Fillimisht u hodh pamja e pilivesës në kompjuter. Duke marrë parasysh manovrat e pilivesës në ajër, u bënë 2000 vizatime të veçanta. Në fund të këtij studimi, u projektua "Sikorski", me modelin e tij të ri dhe shumë të fortë, me lëvizshmërinë e tij të përparuar, i parashikuar për transportin e ushtarëve dhe furnizimeve.

A i keni vënë re sytë e pilivesës? Pilivesat kanë një shikim të përkryer. Sytë e pilivesës janë vlerësuar nga shkencëtarët si sytë më të mirë të insekteve. Secili prej dy syve të pilivesës përmban rreth 30,000 thjerrëza. Këta sy, që ngjajnë si dy hemisfera dhe mbulojnë gjysmën





e kokës së insektit, sigurojnë një fushë të gjerë shikimi. Kështu, edhe ana e pasme është brenda rrezes së shikimit të pilivesës.

Këto janë vetëm disa nga tiparet e pilivesave, të përshkruara shumë shkurt. Përfytyroni sikur një nga këto tipare të pilivesës, si p.sh. ndërtimi i veçantë i krahëve, nuk do të ekzistonte. A do të mundej ky insekt të kryente manovra të papritura dhe të zinte gjahun? Nëse nuk do të kishte sy të aftë për të parë në të gjitha drejtimet, si do t'u shpëtonte armiqve?

Mungesa e njërit nga sistemet që pilivesa zotëron do të rriste rrezikun e mosfunksionimit të sistemeve të tjera. Sidoqoftë, pilivesa është krijuar si tërësi, me të gjitha sistemet e saj. Allahu e krijoi në mënyrë të përsosur pilivesën, ashtu si edhe gjallesat e tjera, ndaj dhe ky insekt jeton një jetë më se normale.



SHTRETËRIT E FSHEHTË NË DETE: KORALET

Ju mund të mendoni se koralet janë vetëm një pirg gurësh shumëngjyrësh. Gaboheni. Koralet janë krijesa të gjalla. Miliarda korale jetojnë së bashku, të ngjitura me njëra-tjetrën nëpërmjet një lënde të veçantë, në një strukturë të ngjashme me gurët.

Mbetjet e koraleve të ngodhura gëlqerizohen dhe shndërrohen në fole koralesh, ku shumë gjallesa detare jetojnë së bashku. Çdo lloj peshku që jeton në një shkëmb koral ka karakteristika të veçanta.

Sjelljet e peshqve që jetojnë në shkëmbinjtë koralë janë të ndryshme. P.sh., disa peshq, si peshku papagall që përmendëm më parë, e kalojnë natën në gjumë të thellë në





çantat e tyre të fjetjes. Disa lloje të tjera peshqish, si shpinëngjitësit, qëndrojnë gjysmë të zgjuar ndërsa pushojnë. Barbuni dhe disa lloje të tjera kanë ngjyra të shndritshme ditën, ndërsa natën e ndërrojnë ngjyrën e lëkurës.

Sfungjerët, koralet dhe disa peshq që shumohen me vezë, gjithashtu, jetojnë në mbetje koralesh të ngordhura. Përveç kësaj, gaforre të vogla dhe karkaleca deti ngjiten nëpër shkëmbinj të koralë për t'u ushqyer me bimë dhe gjallesa mikroskopike. Peshkaqenët dhe ngjalat morej që jetojnë nëpër korale përdorin shqisën e tyre të fortë të nuhatjes për të gjetur ushqim në errësirë.

Gjallesat e ndryshme që Allahu ka krijuar në det, me tiparet e tyre të mrekullueshme, tregojnë fuqinë e pakrahasueshme dhe dijen e pafundme të Zotit tonë. Në suren "En-Nahl", Allahu sjell shembuj të disa krijesave që ka krijuar. Në të njëjtën sure ai i kujton njerëzit se duhet të jenë mirënjohës për krijimin e Tij:

Allahu krijoi për ju në tokë krijesa të ndryshme; në këtë ka argumente për njerëzit që dinë të marrin mësimë. Allahu është Ai që nënshtroi detin, prej të cilit hani mish peshku të freskët dhe nxirrni korale e perla për zbukurim. Ju shihni anijet si lundrojnë në det që ju të kërkon rizkun tuaj prej bujarisë së Tij, dhe kështu ta falëndëroni Atë.

(En-Nahl: 13-14)




JETA NË SHKRETËTIRË

Nxehtësi ekstreme që arrin deri në 50-60°C ditën, i ftohtë i madh gjatë natës, thatësi që mund të zgjasë me javë, madje me muaj të tërë, si dhe shumë pak ushqim. Ju mund të mendoni se është e pamundur të jetosh në këtë vend. Këto mjedise kaq të vështira janë shkretëtirat dhe, në kundërshtim me çfarë mund të mendoni, atje jetojnë shumë gjallesa. Më poshtë do të përmendim vetëm disa prej tyre.

Një prej kafshëve të shkretëtirës është dhelpra ngjyrë kremi, e cila është nga llojet më të vogla të dhelprave (në faqen tjetër). Veshët e kësaj dhelpre janë më të mëdha se ato të dhelprave të tjera. Këta veshë të mëdhenj janë shumë të dobishëm për dhelpren që jeton në shkretëtirat e Afrikës dhe Arabisë. P.sh., dhelpra mund ta gjejë shumë lehtë vendin e gjahut në saje të veshëve të saj të ndjeshëm. Gjithashtu veshët e ndihmojnë kafshën që të mbrohet nga temperaturat e larta.

Një tjetër gjallesë që jeton në shkretëtirë është





hardhuca turilopatë (më poshtë). Për të ftohur bishtin dhe këmbët, kjo krijesë lëviz nëpër rërën e nxehtë sikur të jetë duke kërcyer. Duke u mbështetur te bishti, ajo ngre njëren nga këmbët e përparme dhe një nga të prapmet. Disa sekonda më vonë është radha e dy këmbëve të tjera. Me formën e saj të rrallë të hundës dhe trupit, hardhuca lëviz në pirqje rëre sikur të jetë duke notuar. Këmbët e saj të mëdha bëjnë të mundur që të vrapojë shpejt nëpër rërë, pa u dëmtuar nga nxehtësia.

Bretkosat e shkretëtirës, që jetojnë në Australi, janë si rezervuarë uji. Kur bie shi, një bretkosë shkretëtire mbush qeset e trupit të saj me ujë. Pastaj ajo vetëgroposet në rërë dhe pret deri sa të bien shirat e tjera. Në saje të ujit që ajo ruan në qeset e saj, kjo lloj bretkose mund të mbijetojë në shkretëtirë.

Trupi i gjallesave të shkretëtirës është krijuar posaçërisht për të jetuar në shkretëtirë dhe ato kanë karakteristika tërësisht të ndryshme nga krijesat e tjera. Gjithashtu, këto gjallesa, në pamje të parë, e dinë shumë mirë si të veprojnë për të mbrojtur veten e tyre nga nxehtësia e shkretëtirës dhe si të përballojnë etjen. Si mundet



që një bretkosë ose hardhucë të ketë njohuri të tilla? Si mundet që ato të kenë strukturën e duhur të trupit që e ndihmon të mbijetojë në vende të tilla?

Kafshë të tilla nuk mund t'i dinë këto gjëra nga vetja. Ato as nuk mund të krijojnë rezervuare uji në trupat e tyre, as nuk mund të zmadhojnë veshët për t'u mbrojtur nga nxehtësia. Me qëllim që të mbijetojnë në shkretëtirë, këto krijesa duhet t'i kenë pasur këto karakteristika që kur kanë ardhur në ekzistencë. Përndryshe, ato do të zhdukeshin shpejt nga nxehtësia e madhe, etja ose uria. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur. Për më tepër, të gjitha gjallesat e shkretëtirës kanë aftësinë të durojnë kushtet e saj. Secili lloj ka karakteristikat e tij të veçanta që i bëjnë të mundur të mbijetojë në shkretëtirë.

Të gjitha këto na çojnë në një të vërtetë. Ai që i krijoi gjallesat e shkretëtirës së bashku me tiparet që ato kanë sot është Allahu. Ai ka fuqinë të bëjë çfarë të dëshirojë. Në një ajet të Kuranit, Allahu na bën të ditur se gjithçka për Të është shumë e lehtë:

Ai është krijuesi i qiejve dhe i tokës.

Kur Ai vendos për diçka, vetëm thotë: "Bëhu!" dhe ajo bëhet.

(El-Bekare: 117)





81

SISTEMI I VEÇANTË FTOHËS Ë GAZELËS

Ajri i kondicionuar na mbron nga i nxehti në verë. Sidoqoftë, njerëzit nuk janë të parët që zbuluan sistemin ftohës. Shumë krijesa kanë në trupat e tyre sistemin ftohës që vepron si një kondicioner.

Ne mund të sjellim si shembull gazelën, një lloj antilope afrikane. Si shumë kafshë të tjera, kjo kafshë duhet të vrapojë për të mbijetuar, sepse nuk ka mekanizëm tjetër mbrojtës. Ky vrapim i shpejtë e rrit temperaturën e trupit të saj. Kjo është shumë e rrezikshme për gazelën, sepse me



KRIJESA TË MREKULLUESHME

rritjen e temperaturës së trupit, rritet edhe temperatura e trurit. Me qëllim që një gazelë të mbijetojë, truri i saj duhet të jetë më i freskët se trupi. Kështu që ju mund të pyesni veten se si vepron ajo?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje na çon në faktin e krijimit.

Truri i një gazele ftohet nga një sistem ftohës i vendosur në anën e djathtë të kokës. Gazelat dhe kafshë të tjera të shpejta zotërojnë disa kanale frymëmarrjeje. Qindra vena të vogla gjaku shpërndajnë gjakun e grumbulluar në këto kanale. Ajri që thith gazela, e ftoh këtë zonë dhe kështu, gjaku kalon nëpërmjet këtyre venave të vogla, të cilat pastaj bashkohen në një enë gjaku të vetme që çon gjakun në tru. Në sajë të këtij sistemi, gazela nuk ndikohet nga rritja e nxehtësisë ndërsa vrapon.

Ju duhet të keni arritur në përfundimin se një sistem i tillë i përkryer nuk mund të ketë ardhur në ekzistencë rastësisht, sepse mungesa e këtij sistemi, që kërkohet për ftohjen e trurit, do të thoshte ngordhje për gazelën që në vrapimin e saj të parë.

Sistemi ftohës i gazelës provon përsosmërinë e krijimit të kësaj gjallese. Me fjalë të tjera, struktura e trupit dhe organet e tij nuk mund të vinin në jetë me kalimin e kohës, siç pretendojnë evolucionistët.

Të gjitha krijesat kanë një strukturë organizmi që përbëhet nga disa sisteme, të cilat nuk mund të funksionojnë nëse mungon qoftë edhe një përbërës i vetëm. Kjo provon se

gjallesat nuk kanë ardhur në jetë si rezultat i rastësisë, por janë krijuar nga Allahu. Kjo është më se e qartë për ata që i kushtojnë vëmendje kësaj çështjeje dhe përdorin mençurinë e tyre. Allahu thotë në një ajet kuranor:

"... Zoti i lindjes dhe përëndimit dhe i gjithçkaje tjetër ndërmjet tyre, nëse jeni prej atyre që përdorin arsyen."

(Esh-Shu'ara': 28)



FUQIA E QUKAPIKËVE

Qukapikët i ndërtojnë foletë e tyre dhe sigurojnë ushqimin duke çukitur nëpër pemë.

Shpejtësia, me të cilën një qukapik hap vrima nëpër pemë është afërsisht 40 km/orë. Kjo, në fakt, është një shpejtësi e jashtëzakonshme që, në kushte normale, mund ta dëmtonte qukapikun. Megjithatë, ai ka një sistem të veçantë mbyllës në sqepin e vet, që e ndihmon të mos dëmtohet. Nëse ky sistem nuk do të ekzistonte, sqepi i qukapikut do të ndahej më dysh për shkak të shpejtësisë së madhe. Përveç kësaj, nëse ndikimi i goditjes do të shkonte drejt e në tru, zogu do të humbiste ndjenjat. Mirëpo një gjë e tillë nuk ndodh kurrë, pasi Allahu e ka krijuar zogun së bashku me gjithçka që i nevojitet. Truri i qukapikut është i vendosur në të njëjtin nivel me sqepin e tij.

Muskujt në pjesën e ulët të sqepit veprojnë si “amortizatorë” dhe amortizojnë tronditjet që shkaktohen gjatë çukitjes nëpër pemë.



Deri tani kemi përmendur disa karakteristika të qukapikut. Përveç tyre, çdo qukapik ka edhe karakteristika të tjera të jashtëzakonshme. Një lloj qukapiku fsheh lëndë nëpër pemë. Gjatë verës, qukapikët shpojnë “vrime” në një kërcu peme të tharë dhe në fund të verës i mbushin këto vrime me fara, me të cilat do të ushqehen gjatë dimrit. Duke vepruar si një çekan, ai vendos një kokërr drithi në secilën vrimë. Kjo i merr goxha kohë qukapikut, sepse ai përpiqet të gjejë kokrrën që përshtatet me vrimën e hapur. Nëse vrima është e madhe dhe kokrra është e vogël, atëherë ajo mund të merret shumë lehtë nga zogjtë e tjerë. Nëse vrima është më e vogël se kokrra e drithit, atëherë ajo do të dëmtohet ndërsa futet me forcë brenda. Për këtë arsye, duhet shumë kohë për qukapikun që të vendosë kokrrën e drithit.

Por jo gjithçka mbaron me kaq. Qukapiku ka ende shumë për të bërë. Meqë me kalimin e kohës kokrrat e drithit thahen, ato bëhen edhe me të vogla. Kjo do të thotë që qukapikët duhet të vendosin kokrra drithi të thata nëpër vrime.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh se qukapikët nuk mbledhin vetëm 5 apo 10 kokrra drithi. Një qukapik drithërash mund të

vendosë deri në 50,000 kokrra drithi në një pemë të madhe.

Duke medituar mbi këto karakteristika interesante, ne kuptojmë se ekziston një fuqi e mbinatyrshme që u mëson këtyre qukapikëve të veprojnë kështu. Kjo fuqi është Allahu. Ai ua krijoi sqepin qukapikëve aq të fortë, sa të shpojne lëvoren e pemëve. Është Allahu Ai që u mësoi atyre çdo gjë që bëjnë. Nuk ka asnjë zot apo krijues tjetër përveç Allahut. Ai na bën të ditur në Kuran se është Krijuesi i gjithçkaje:

Ky është Allahu, Zoti juaj. Askush nuk e meriton adhurimin përveç Tij, Krijuesi i çdo gjëje, ndaj adhuroni vetëm Atë. Ai është vëzhgues për çdo gjë. (El-En'am: 102)



Një qukapik që depoziton kokrra drithi në vrimat e një trungu lisi (majtas, lart) dhe një lloj tjetër qukapiku (djathtas).

KETRAT ME FAQE TË MËDHA

Ketri që ju shihni në foton më poshtë është ketri i tokës, gjithashtu i quajtur ketri faqetrastë. Ajo që e dallon këtë lloj ketri nga të tjerët është se ai ruan në trastat e faqeve të tij ushqimin që nuk e konsumon. Ketri grumbullon ushqimin për ta përdorur më vonë.

Këto trasta janë, në të vërtetë, pjesë të lira të lëkurës. Shtresa e brendshme e këtyre mbajtëseve është e thatë, prandaj edhe ushqimi mund të ruhet në këto





87



trasta për një kohë të gjatë pa u prishur. Për të mbushur këto trasta, ketri merr një arrë ndërmjet putrave të tij dhe pret pjesët me të mprehta në të dyja anët me dhëmbët e tij. Pastaj vendos gjysmën e arrës në një nga trastat dhe gjysmën tjetër në një tjetër. Trastat mbushen, në këtë mënyrë, njëra pas tjetrës. Kafsha mund të vendosë katër arra në secilën trastë. Kështu, faqet e ketrit ndryshojnë dhe i japin atij një pamje interesante dhe tërheqëse.

ZOGU ME KRAHËT MË TË GJATË NË BOTË: ALBATROSI

Albatrosët janë zogj oqeanikë me krahë shumë të gjatë, rreth 3.5 metra. Ata kalojnë 92% të jetës së tyre në det dhe vijnë në tokë vetëm për t'u shumuar. Karakteristika më e rëndësishme e këtyre zogjve është që ata mund të fluturojnë për një kohë shumë të gjatë pa u ndalur. Ata e kryejnë këtë detyrë të vështirë duke u mbështetur në stilin e fluturimit të tyre.





Me qëllim që të fluturojë, është e mjaftueshme për një albatros të hapë krahët e tij të gjera. Në këtë mënyrë, ai mund të fluturojë për orë të tëra pa i përplasur fare krahët. Zogu e bën këtë duke i shtrirë krahët e tij sa më shumë që të jetë e mundur. Largësia e krahëve të tij arrin deri në 3.5 metra. Kjo është gjatësia më e madhe e krahëve ndër të gjithë llojet e zogjve.

Duke përdorur rrymat e ajrit dhe erën, albatrosët lëvizin në drejtimin e tyre. Kështu, albatrosët fluturojnë mbi det për orë të tëra pa i rrahur krahët. Po si është e mundur që ta kryejnë një detyrë kaq të vështirë? Çfarë i bën këta zogj kaq të fortë?

Së pari, një energji shumë e madhe është e nevojshme për të mbajtur hapur ato krahë gjigandë të hapur në mënyrë konstante. Për ta kuptuar më mirë këtë detyrë të vështirë që albatrosët kryejnë, le të krahasojmë albatrosët me njerëzit. Është e vështirë për një njeri të mbajë krahët e tij të hapur për një kohë të shkurtër. Shpejt krahët fillojnë t'i dhembin dhe ai

detyrohet t'i ulë. Megjithatë, albatrosët mund të qëndrojnë në ajër për disa orë me krahët e tyre të hapur.

Në kockat e krahëve të albatrosit gjendet një sistem mbyllës që u mundëson atyre t'i mbajnë krahët të hapur. Me anë të këtij sistemi mbyllës, ata nuk përdorin ndonjë fuqi muskulare. Kjo e bën më të lehtë fluturimin e këtij zog. Në saje të këtij sistemi të veçantë, albatrosët mund të fluturojnë pa u ndalur për ditë, javë, madje edhe muaj, duke harxhuar vetëm një sasi të vogël energjie.

Mjafton vetëm një çast për të kuptuar që këto tipare nuk mund të kenë ardhur në ekzistencë rastësisht. Ne shohim mëshirën dhe mirësinë e Allahut për këta zogj që fluturojnë për një periudhë të gjatë mbi dete. Është Allahu Ai që u ka dhuruar albatrosëve të gjitha këto tipare që u nevojiten për të mbijetuar. Allahu, i Cili ka fuqi mbi gjithçka, i mbron dhe u jep albatrosëve gjithçka që u nevojitet, siç bën edhe me çdo krijesë tjetër. Allahu bën fjalë për zogjtë në një ajet kuranor ku thotë:

A nuk i shohin zogjtë si janë të përshtatur për fluturim në qiell? Asgjë nuk i mban ata përveç Allahut. Në këtë fakt ka argumente për njerëzit që besojnë.

(En-Nahl: 79)



ARTISTËT E ZBUKURIMEVE: ZOGU TENDË

A e dinit ju që këta zogj zbukurojnë foletë e tyre? Ashtu si qeniet njerëzore që stolisin vendin ku jetojnë, disa lloje zogjsh zbukurojnë foletë e tyre. Sjellja e këtyre zogjve është e mrekullueshme. Ndonjëherë ata stolisin foletë e tyre me objekte zbukuruese që mbledhin andej-këndeje ose pikturojnë muret e foleve të tyre me fruta me ngjyrë.

Zogu tendë, një lloj zogu australian që është një nga shpendët që pikturon fole të tij është me të vërtetë "ekspert i arkitekturës". Masa e mashkullit është sa e një pëllumbi. Ndërsa ndërtojnë fole të tyre, ata ndërthurin dhjetëra degë të holla në dy radhë, secila përballë tjetrës, siç shihet edhe në figurë. Në këtë mënyrë, ata ndërtojnë një lloj tende. Zogu i



grumbullon të gjitha materialet e marra nga mjedisi rrethues përballë kësaj tende. Materialet janë nga më të ndryshmet. Ato mund të jenë krahu i një fluturë, penda e ndonjë zogu, çelësat e një makine ose disa letra paketimi. Ky lloj zogu është i interesuar veçanërisht për objektet në ngjyrë të kaltër. Siç mund ta shihni edhe në figurë, ai ka grumbulluar në folenë e tij të gjitha objektet e kaltra që ka gjetur.

Përveç kësaj, ai përdor edhe disa mënyra të tjera stolisjeje. Zogu tendë pikturon muret e folesë se tij. Doni ta dini se si? Ai mbledh bimë të ngjyrave të ndryshme dhe pikturon muret duke përdorur copa prej tyre. Ndonjëherë përdor qymyr që e përziën me jargët e veta. Ai i pikturon muret e folesë se tij, të ndërtuara me degë, edhe me një copë lëvore druri që mban në gojë.

Allahu është Krijuesi i të gjitha llojeve të zogjve, qofshin këta të rrallë si zogjtë tendë, qofshin ndër ata që i shohim më shpesh, si pëllumbat dhe harabelat. Allahu i Gjithëlavdishëm u mëson zogjve të vegjël si të ndërtojnë dhe zbukurojnë folenë e tyre. Ajo çka neve na takon të bëjmë është të mendojmë në mënyrë të veçantë mbi këto karakteristika të kafshëve për të kuptuar më mirë fuqinë e madhe të Allahut, i Cili thotë në një ajet kuranor:

Ai ka bërë gjithçka në qiej dhe në tokë të dobishme për ju. Gjithçka është nga Ai. Në këtë fakt ka argumente për njerëzit që mendojnë. (El-Xhathije: 13)



ZOGJTË QË NDËRTOJNË FOLE PËR PASARDHËSIT E TYRE

Megapodët jetojnë në Australi dhe ndërtojnë fole shumë të veçanta për vezët e tyre. Megapodi mashkull gërmon një vrimë të madhe dhe e mbush atë me lëndë të lagura e bimë të kalbura. Zogu ka një arsye të veçantë dhe të rëndësishme që vepron kështu. Bakteriet në bimët e kalbura prodhojnë nxehtësi, kështu që foleja e tij ngrohet. Me qëllim që të mbajë temperaturën konstante, mashkulli bën ajrimin dhe vazhdimisht kontrollon temperaturën e folesë duke ngulur sqepin e tij në këto vrima. Ai bën, gjithashtu, një dalje në formë hinke në sipërfaqen e pirgut të bimëve. Kjo dalje lë shiun të pikojë brenda pirgut gjatë dimrit dhe në këtë mënyrë, e mban atë të njomur. Pasi foleja është gati, femra vjen dhe lëshon vezët e saj në vrimën e hapur.

Megjithatë, temperatura e folesë rritet vazhdimisht gjatë verës, ndaj dhe mashkulli megapod mbulon folenë me rërë. Kjo mënyrë bën të mundur ndalimin e rritjes së nxehtësisë në fole.

Tani, le të shtrojmë një pyetje. Para se të lexonit këto rreshta, a e dinit se nga bimët e kalbura çlirohet nxehtësi? Është e natyrshme që të mos e keni ditur nëse nuk keni qenë informuar nga ndonjë tekst i specializuar. Shumë njerëz nuk e dinë. Megjithatë, megapodët kanë njohuri për këtë fakt. Për më tepër, ata e përdorin këtë njohuri në dobi të pasardhësve të tyre.

Po si është e mundur që një zog të bëjë llogaritje kaq delikate dhe të mençura? Si mundën zogj të tillë të marrin masa të tilla parandaluese? Pse kryejnë një detyrë kaq të vështirë për pasardhësit e tyre?

Me qëllim që të bëjë të gjitha këto, një zog duhet të ketë njohuri teknike të një inxhinieri dhe aftësitë intelektuale të një qenieje njerëzore. Natyrisht, një zog nuk ka arsyen dhe trurin për të vepruar si një njeri i mësuar. Ka një fuqi që i drejton zogjtë dhe bën të mundur që megapodët të kryejnë këto



detyra që kërkojnë përdorimin e arsyes. Kjo fuqi është Allahu, i Cili krijoi çdo gjë në mënyrën me të përsosur.

Nga sa lexoni në këtë libër, është e lehtë të kuptohet se këto krijesa nuk mundën t'i bëjnë të gjitha këto gjëra të mrekullueshme vetë, pa aftësitë dhe ndihmën e dhënë nga Allahu, i Cili ka krijuar gjithçka. Megjithatë, ka njerëz që nuk pranojnë këtë fakt. Allahu na tregon për këta njerëz në Kuran:

Thuaj (o Muhamed): "Kush është zoti i tokës dhe qiejve?" (Ata nuk kanë përgjigje tjetër ndaj) thuaj: "Allahu."

Thuaj: "Atëherë si ka mundësi që në vend të tij adhuroni zota të tjerë, të cilët nuk kanë mundësi t'i sjellin as dobi e as dëm vetvetes?"

Thuaj: "A është i barabartë i verbëri me atë që sheh? A krahasohet errësira me dritën?"

A mos vallë ata adhuroan në vend të Allahut zota që kanë krijuar ashtu siç krijon Ai, ndaj dhe ata nuk janë në gjendje të dallojnë krijimin e Allahut nga krijimi i zotave të tjerë?"

Thuaj: "Allahu është krijuesi i çdo gjëje.

Ai është i vetmi që meriton të adhurohet dhe Ai është ngadhënjyes mbi çdo gjë." (Er-Ra'd: 16)



KUJTESA E FUQISHME E GRIFSHËS

Grifshat mbledhin kokrra drithi dhe i groposin ato në tokë për përdorim të mëvonshëm. Ndonjëherë ato groposin deri në mijëra kokrra drithi në ditë. Çdo gjë në pyll duket njëlloj. Kjo është arsyeja pse është e vështirë madje edhe për një njeri të gjejë një vend të caktuar në një pyll. Atëherë si mundet që grifshat e gjejnë vendin ku kanë fshehur ushqimin e tyre? Ato veprojnë në mënyrë shumë të zgjuar dhe e shënojnë vendin duke përdorur tri degë ose copa gurësh. Sidoqoftë, është shumë e vështirë të gjesh diçka të groposur në një pyll. Megjithatë, eksperimentet kanë treguar se këta zogj mund të gjejnë kokrrat e drithit edhe nëntë muaj me vonë. Është një mrekulli e krijimit që këta zogj kanë një kujtese kaq të fortë.

Natyrisht, nuk është e mundur të shpjegojmë sjelljen e grifshës për të fshehur kokrrat e drithit, duke i groposur në tokë ose duke i shënuar këto vende të fshehta për t'i gjetur me vonë.

Duke groposur mijëra kokrra drithi dhe duke shënuar vendet e tyre me gurë dhe degë në mënyrë të rregullt, ky zog kryen diçka shumë të habitshme. Është shumë e natyrshme për një zog të ushqehet me drithë sapo e



gjen, por vetëm një qenie inteligjente mund t'i ruajë për përdorim të mëvonshëm, të shënojë vendin ku ka fshehur ushqimin dhe ta njohë këtë shenjë më vonë.

Një zog nuk mund të bëjë vetë asgjë nga këto. Kështu, ne e kuptojmë se ka një qenie që zotëron mençuri e urtësi të pafund, ka fuqi mbi gjithçka dhe frymëzon grifshën të veprjës siç u tregua më sipër. Kjo mençuri e urtësi e madhe i përket Allahut, i cili krijoi gjithçka me një rregull të përsosur.

TANKET E BLËNDUARA TË MBRETËRISË SË KAFSHËVE

Këto kafshë të Amerikës së Jugut, të cilat quhen armadijo, kanë një pamje shumë interesante për shkak të koracës që mbulon trupin e tyre. Këto krijesa ushqehen me insekte dhe zakonisht kërkjnë ushqim duke gërmuar në tokë. Armadijot kanë një shqisë të mprehtë nuhatjeje. Duke nuhatur erën e ushqimit, armadijo vendos hundën e tij në tokë dhe

gërmon me shpejtësi sikur ka frikën e humbjes së erës.

Shumëkush mund të habitet kur sheh si armadijo arrin të marrë frymë ndërsa





gërmon. Por armadijot nuk marrin frymë në kohën e gërmimit. Në të vërtetë, ata janë në gjendje të mbajnë frymën e tyre deri në 6 minuta.

Në saje të aftësisë së dhuruar nga Allahu për të mbajtur frymën për një kohë të gjatë, armadijot mund të gërmojnë nën tokë dhe të gjejnë ushqimin e tyre. Ky shembull tregon mëshirën e Allahut ndaj këtyre krijesave. Në një ajet, Allahu na njuh me veten e tij:

Vërtet Zoti yt është i Gjithëfuqishmi, Mëshirëbërësi.

(Esh-Shu'ara': 9)

ZOGJTË SHTEGTARË QË MUND TË FLUTUROJNË EDHE NATËN

Shumë lloje zogjsh udhëtojnë me mijëra kilometra çdo vit në vende ku mund të gjejnë burime të pasura ushqimi, ku mund të lëshojnë vezët dhe të rrisin të vegjlit e tyre. Allahu na tregon për fluturimin e zogjve në një ajet kuranor:

A nuk i shohin njerëzit zogjtë që fluturojnë sipër tyre duke hapur e mbyllur krahët? Asgjë nuk i mban në ajër përveç



Fuqplotit, i Cili sheh çdo gjë. (El-Mulk: 19)

Shumë zogj ujin kryejnë fluturime në largësi të mëdha në saje të ndërtimit të trupit dhe aftësisë së komunikimit ndërmjet tyre. Zogjtë ujin komunikojnë gjatë fluturimit duke kënduar dhe duke prodhuar tinguj të ndryshëm. Kështu bën çdo anëtar i grupit, madje edhe në mes të natës, pa marrë parasysh sa të shumtë janë në numër.

Çdo pjesëtar i turmës e di ku janë të tjerët. Shkencëtarët mendojnë se zogjtë e ujit përdorin diellin për të gjetur vendndodhjen e tyre. Kur janë pranë vendndodhjes së tyre, ata

Zogjtë në fluturim janë një nga shenjat që Allahu përmend në Kuran dhe na nxit të mendojmë rreth tyre.





njohin disa shenja. Kjo është e ngjashme me përdorimin e rrugëve dhe ndërtesave të caktuara për të gjetur shtëpinë tuaj. Në mënyrë të ngjashme, zogjtë e ujit ndjekin lumenjtë, malet dhe shenja të tjera tokësore. Disa zogj ujqorë mund të fluturojnë pa u ndalur natën dhe ditën gjatë shtegtimit të tyre.

Aftësia për të gjetur drejtimin është karakteristikë për qeniet njerëzore që janë të pajisura me arsye. Njeriu mund të gjejë drejtimin e tij duke përdorur disa teknika ose me ndihmën e diellit, por si munden zogjtë ta gjejnë drejtimin e tyre? Si munden ata të shfrytëzojnë pozicionin e diellit apo shenjat e tjera?

Në ajetin kuranor të përmendur më sipër thuhet: “A nuk i shohin njerëzit zogjtë që fluturojnë sipër tyre duke hapur e mbyllur krahët..?” Me anë të këtij ajeti Allahu na tërheq vëmendjen ndaj fluturimit të zogjve. Ai kërkon prej nesh që të mendojmë mbi këtë aftësi që u ka dhuruar atyre. Duke menduar në këtë mënyrë, ne arrijmë në përfundimin se sjelljet inteligjente dhe aspektet e përsosura fizike të krijimit nuk mund të jenë fryt i rastësisë.


Mendoni rreth fakteve të tilla dhe ndajini mendimet tuaja me njerëz të tjerë! Sigurohuni që edhe ata të kuptojnë madhësitinë e Allahut dhe faktin se është Ai që ka krijuar gjithçka.

PASTRUESIT E DETIT

Çfarë mendoni ju nëse shikoni një peshk të vogël që është gati të hyjë në gojën e një peshku të madh? Do të mendoni se peshku i madh do ta gëlltisë peshkun e vogël dhe do të çuditeni se si peshku i vogël qëndron aq pranë tij.

Pa dyshim, kjo është diçka e veçantë që peshku i madh e lejon peshkun e vogël të notojë rreth tij, nuk e sulmon dhe nuk do t'ia dijë fare nëse është duke notuar edhe brenda gojës ose nën gushën e tij. Megjithatë, është e mundur të shohësh shpesh pamje të tilla në oqeanë. Peshqit e vegjël nuk janë të vetmet gjallesa që notojnë pa frikë pranë peshkut të madh. Ndonjëherë mund të shihen edhe karkaleca deti afër peshqve të mëdhenj. Këta janë karkalecat pastrues, puna e të cilëve është të pastrojnë disa nga peshqit e mëdhenj.





Ka shumë lloje karkalecash pastrues deti. Ky që shihet në foto është një prej tyre. Vija e kuqe dhe e bardhë e karkalecit të detit e bën atë të dukshëm, të ngjashëm

me një dritë dhe ndihmon peshqit që u duhet të pastrohen për të dalluar atë. Kur karkaleci, me dy antenat e gjata të bardha, vendoset pranë peshkut, ky i fundit pret në mënyrë shumë të durueshme karkalecin për të ngrënë parazitët në lëkurë ose në vendet e dëmtuara. Karkaleci pastrues mund të futet edhe në gojë për të hequr parazitët që bezdisin peshkun. Në këtë mënyrë, karkaleci gjen edhe ushqimin e vet. Karkaleci i detit vazhdon të punojë derisa të sigurohet se peshku është pastruar. Kur puna mbaron, peshku i madh nuk i shkakton as edhe dëmin më të vogël karkalecit që në fakt mund të jetë një ushqim shumë i mirë. Karkaleci i detit vepron pa u shqetësuar dhe pa u frikësuar nga peshku i madh. Siç shihet edhe në foto, këto dy krijesa shkojnë shumë mirë me njëra-tjetrën.

Konceptet e “të shkuarit mirë” apo “të dhënit garanci” etj. janë karakteristike për njerëzit që kanë arsye dhe inteligjencë. Ato nuk mund të vlejné

për këto gjallesa ujore. Megjithatë, Allahu, që ka kontroll dhe fuqi mbi gjithçka, i mëson këto krijesa të sillen kështu dhe të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën.



GJINKALLA E ZHURMSHME

Gjinkalla është një insekt i zhurmshem. Ajo prodhon gumëzhitje me anë të një sistemi në trupin e saj. Poshtë barkut të insektit gjenden një çift organesh membranozë. Gjinkalla prodhon atë tingull shumë të njohur duke dridhur këto membrana si daulle. Kur këto membrana tërhiqen dhe lëshohen nga muskujt me të cilët janë ngjitur, prodhohet një tingull i ngjashëm me atë të një ene të zbratur metalike. Insekti e përsërit këtë tërheqje-lëshim 500 herë në sekondë. Duke marrë parasysh që ju mund të mbyllni dhe të hapni sytë vetëm një herë në sekondë, shpejt mund të shikoni se sa e vështirë është ta kryesh këtë 500 herë në sekondë.

Me hapjen dhe mbylljen e pjesës së jashtme që ndodhet në zonën më të ulët të kafazit të krahavorit të insektit, niveli i tingullit mund të rritet dhe të ulet. Syri i njeriut nuk mund t'i dallojë këto hapje e mbyllje që ndodhin në të dhjetën e sekondës. Ne nuk e vëmë re as faktin se tingulli është i ndërprerë dhe mendojmë se tingulli gumëzhitës i gjinkallës është i vazhdueshem.



ZOGJTË PASTRUES

*Zogjtë
që shikoni
në foto janë*

zogjtë pastrues. Këta zogj ushqehen me parazitët që jetojnë në lëkurën e disa kafshëve si rinocerontët, elefantët apo zebtrat. Për këtë arsye, këto kafshë nuk shqetësohen prej këtyre zogjve edhe kur i kanë mbi trup e mbi kokë.

Kjo lidhje është me leverdi për të dy palët. Në këtë mënyrë, kafshët heqin parazitët dhe lajmërohen, gjithashtu, nga zogjtë që ngrenë zërat e tyre në rast rreziku. Në shkëmbim, zogjtë sigurojnë ushqimin dhe madje edhe qimet për të mbuluar pjesën e brendshme të folesë se tyre.



PATINATORËT E PELLGUT QË ECIN MBI UJË

Është e pamundur për qeniet njerëzore të ecin në sipërfaqe të ujit. Megjithatë, disa gjallesa e bëjnë këtë me anë të strukturës së veçantë të trupit që Allahu u ka dhënë. P.sh., një lloj insekti që quhet patinatori i pellgut ecën sipër ujit duke shtypur këmbët e tij të gjata dhe të holla me lëkurë elastike në sipërfaqe të ujit. Kur këmbët e insektit shtynë ujin, një vrimë e vogël formohet në sipërfaqe. Në këtë mënyrë, insekti shpërndan peshën e tij të trupit mbi një sipërfaqe të gjerë.

Vëzhgimet kanë treguar se këmbët e patinatorëve të pellgjeve nuk e thyejnë sipërfaqen e ujit. Me fjalë të tjera, këmbët e tyre nuk hyjnë në ujë. Si rezultat, patinatorët e pellgjeve kanë mundësi të ecin në sipërfaqe të ujit ndërsa krijesa të tjera nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë.






Pamja e jashtme e peshkut thithës më poshtë.



KËMBËNGULJA E PESHKUT THITHËS

E veçanta e peshqve thithës është se ata përdorin anijet ose peshkaqenët për t'u përhapur në oqean. Pendët e peshkut janë si një disk oval thithës. Ai mund të lëvizë me ndihmën e gjithçkaje, e gjallë ose jo e gjallë. Pavarësisht nga fakti se sa shpejt noton objekti apo gjallesa pas së cilës ngjiten, peshqit thithës nuk lëshohen për asnjë çast prej tij. Në foton më sipër shihen peshq thithës që i janë ngjitur nga poshtë një peshkaqeni. Në një ajet kuranor Allahu i Madhëruar thotë:

Çdo gjë në tokë dhe në qiej i përket vetëm Allahut. Dija e Allahut përfshin çdo gjë. (En-Nisa: 126)





PESHKU ME BUZË TË KUQE

Peshku lakuriq nate me buzë të kuqe është i vetmi peshk në botë që ecën me të katër pendët. Ato pendë janë të përcaktuara pikërisht për të bërë të mundur ecjen. Ai ka, gjithashtu, një hundë me pamje të çuditshme dhe buzë të kuqe e të mëdha. Këto bëjnë që pamja e jashtme e peshkut të duket e veçantë. Ato që i mundësojnë peshkut lakuriq nate të ecë në fund të detit si një qenie njerëzore janë pendët e tij të krahavorit dhe të legenit. Duke përdorur këto pendë, ky lloj peshku mund të qëndrojë shumë lehtë në fund të detit dhe të zhvendoset mbi majat e pendëve.

Përveç kësaj aftësie, peshku lakuriq nate ka një tipar tjetër interesant. Ai ka disa shtojca poshtë hundës, të cilat i përdor si një vijë peshkuese për të mashtruar peshq të tjerë. Këto lloje peshqish janë mishngrënës. Duke përdorur këtë linjë peshkuese, ata gjuajnë peshq të tjerë, gaforre, larva dhe midhje. Ky krijim i ndërlikuar në këta peshq të vegjël që jetojnë në fund të detit na tregon edhe një herë një nga shembujt e shumtë të forcës krijuese të Allahut.




ÇAFKAT SHUMËNGJYRËSHE

Çafkat mund të shihen pothuajse në çdo zonë ku ka ujë. Çafka e madhe ngjyrë blu që shohim në figurë është zogu më i gjatë që jeton në Amerikën e Veriut.

Vendi i folesë ku çafkat mblidhen është, zakonisht, në një zonë të fshehtë e të thellë që është shumë e vështirë për njerëzit të arrijnë ta gjejnë. Një lloj tjetër çafke ka ngjyra të ndryshme gjatë pranverës, ndërsa i shfaqen ngjyra të reja rreth sqepit shumëngjyrësh gjatë kohës së ndërtimit të folesë.

Allahu i krijoi zogjtë me ngjyra të ndryshme. Ne kënaqemi duke parë ngjyrat e bukura në puplat e zogjve. Kjo larmi ngjyrash tek zogjtë është një nga shenjat e krijimit të mrekullueshëm të Allahut. Në Kuran, Allahu tregon se Ai është krijuesi i ngjyrave:

A nuk e sheh se Allahu e zbrit shiun nga qielli dhe nëpërmjet tij nxjerr fruta me ngjyra të larmishme?



Ai krijoi malet në të cilat gjenden rrugë të bardha dhe të kuqe, me ngjyra të ndryshme dhe të tjera tepër të zeza.

Po kështu ai krijoi njerëzit, kafshët dhe bagëtitë me një larmi ngjyrash.

Me të vërtetë, ata që i frikësohen më shumë Allahut ndërmjet robërve të Tij, janë dijetarët. Allahu është i Gjithëfuqishëm dhe Falës i Madh (Fatir: 27-28)

PARAKETI, PAPAGALLI QË JETON NJË MUAJ PA UJË

Paraketët e egër jetojnë në Australi në një zonë ku rrallë bie shi. Pasi sigurojnë nevojat e tyre për ujë nëpërmjet farave me të cilat ushqehen, këta zogj e kanë shumë të lehtë të jetojnë pa pirë ujë për një muaj në stinët më të thata. Uji është jetësor për paraketët e egër. Për këtë arsye, ata mund të organizojnë gjithë jetën e tyre sipas kushteve klimatike.





P.sh., nëse uji nuk është i mjaftueshëm, ata ndalojnë se shumuari dhe fillojnë të kërkojnë një vend të ri me ujë. Sapo gjejnë një vend të tillë, fillojnë që të bëjnë vezët. Është frymëzimi i Allahut që i bën paraketët të organizojnë jetën e tyre sipas kushteve klimatike. Meqenëse uji është jetik për vazhdimësinë e këtyre gjallesave, ato ndalen së shumuari menjëherë. Zoti ynë, që di çdo gjë rreth krijesave të Tij, i frymëzon ato të sillen në mënyrë shumë të zgjuar. Në një ajet, Allahu thotë:

Shtatë qiejt dhe toka dhe çdo gjë që ekziston në to bëjnë lavde për Allahun. Nuk mund të gjesh asnjë krijesë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij, por ju nuk mund ta kuptoni lavdërimin e tyre. Ai është gjithnjë i Durueshëm, Falës i Madh. (El-Isra': 44)





NDËRTIMI I PENDËVE TË ZOGJVE

Dallimi më i madh që i veçon zogjtë nga krijesat e tjera është, natyrisht, aftësia e tyre për të fluturuar. Zogjtë mund të fluturojnë në saje të krahëve të tyre, të cilët kanë një ndërtim shumë të veçantë.

Pendët e zogjve kanë një strukturë me peshë të lehtë dhe munden me shumë lehtësi të rifitojnë formën e tyre origjinale. Nëse shohim një pendë zogu në mikroskop, do të vërejmë një krijim të mrekullueshëm. Në mesin e pendës ndodhet një bosht qendror i fortë që ka një helikë pendësh çift, të quajtura shigjeta. Këto shigjeta, gjatësia dhe butësia e të cilave është e ndryshueshme, bëjnë të mundur që zogu të fluturojë në ajër.

Ndërsa ne shqyrtojmë hollësi të mëtejshme, gjejmë struktura edhe më interesante. Një rrjetë puplash të vogla, të quajtura "barbule" vihen re më tej. Barbulet nuk mund të shihen me sy të lirë. Në to ka grepa të vegjël. Barbulet janë të ndërthurura nga këto grepa si në zinxhir.

Grepat janë të shtrënguar si dy anët e një hallke zinxhiri. Barbulet, të mbajtura lidhur nga



grepat, janë aq afër njëra-tjetrës, saqë edhe tymi i cigares nuk mund të kalojë mes tyre. Nëse këto grepa janë, në njëfarë mënyre, të pambyllur është e mjaftueshme për një zog të shkundë puplat ose të vendosë pendët në rregull me sqepin e tij dhe të bëjë që pendët të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Me qëllim që të mbijetojnë, zogjtë duhet që të mbajnë pendët e tyre të pastra, të rregullta dhe në gatishmëri për të fluturuar. Ata përdorin qese vaji që ndodhen në fund të bishtit. Ata marrin pak vaj me sqepin e tyre dhe pastaj pastrojnë e lyejnë pendët e tyre. Tek zogjtë notues, ky vaj pengon ujin të arrijë në lëkurë, kur janë në ujë ose kur bie shi.

Secili grup i pendëve në një pjesë të trupit ka një funksion të veçantë. P.sh. pendët e poshtme dhe pendët që shtrihen përgjatë krahëve dhe bishtit kanë një strukturë të ndryshme. Pendët e gjata të bishtit përdoren për të ruajtur drejtimin, si





Shikoni një pendë zogu në mikroskop dhe do të vëreni strukturën e ndërthurur me grepa të një pendë.

edhe për frenim. Ndërsa pendët e krahëve hapen shumë gjatë fluturimit, edhe sipërfaqja e shtrirjes së krahëve zmadhohet, si rrjedhojë edhe forca e ngritjes rritet. Kur zogu përplas krahët e tij poshtë, këto pendë afrohen dhe pengojnë ajrin të kalojë. Kur lëvizin krahët, pendët hapen shumë dhe lejojnë ajrin të kaloj mes tyre. Me qëllim që të ruajnë aftësinë e fluturimit, zogjtë ndërrojnë pendët në kohë të veçanta gjatë vitit. Pendët që nuk funksionojnë mirë rinovohen shumë shpejt.

Kjo strukturë e hollësishme ekziston në pendët e çdo zogu. Të gjithë ata kanë tiparet e nevojshme që i ndihmojnë të fluturojnë. Çdo njeri që mendon mbi ato që u shpjeguan këtu dhe përdor arsyen do të vërë re mrekullinë në krijimin e zogjve dhe do ta kuptojë që ky krijim është vepër e Allahut.

Edhe Kurani nxit besimtarët të mendojnë për krijimin e Allahut:

Sundimi i qiejve dhe i tokës i takon vetëm Allahut. Allahu ka fuqi mbi çdo gjë.

Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës dhe të ditës, ka pa dyshim argumente për njerëzit që llogjikojnë: Ata e kujtojnë dhe e përmendin Allahun në këmbë, të ulur e të mbështetur në krah dhe mendojnë thellë mbi krijimin e qiejve dhe të tokës (duke thënë):

Zoti ynë! Ti nuk e ke krijuar të gjithë këtë pa qëllim. I lavdëruar qofsh! Na ruaj prej ndëshkimit të zjarrit.

(Ali 'Imran: 189-191)

TEKNIKAT E FLUTURIMIT TË ZOGJVE

Një energji shumë e madhe kërkohet për të fluturuar. Zogjtë janë krijesa të vogla dhe energjia që ata mund të mbajnë në trupin e tyre është shumë e vogël. Zogjtë e ruajnë pjesën më të madhe të energjisë me anë të zbatimit të teknikave të veçanta të fluturimit. Të fluturuarit në ajër pa përplasur krahët është një nga teknikat e tyre. P.sh., korbat përdorin një metodë të veçantë duke u mbështetur në rritjen e nxehtësisë së rrymave të ajrit me qëllim që të arrijnë në një lartësi më të favorshme. Duke zbritur nga një rrymë ajri e nxehtë në një tjetër, ata mund të fluturojnë për një kohë shumë të gjatë.

Zogjtë shtegtarë, gjithashtu, përdorin teknikat e zbritjes për të ruajtur energjinë. Lejlekët përdorin rrymat e nxehta gjatë migrimit. Lejlekët e bardhë të Europës Qendrore shtegtojnë për të kaluar dimrin në Afrikë dhe përshkojnë një distancë



rreth 7,000 kilometra. Nëse do të përplasnin krahët e tyre gjatë gjithë rrugës, do t'u duhej të pushonin disa herë gjatë udhëtimit. Megjithatë, lejlekët e bardhë kryejnë udhëtimin e tyre në tri javë duke zbritur ndërmjet rrymave të nxehta për 6-7 orë në ditë dhe kështu ruajnë shumicën e energjisë.

Meqenëse uji i detit ngrohet më ngadalë se toka, mbi det nuk ka rryma të nxehta. Për këtë arsye, zogjtë shtegtarë pëlqejnë të shtegtojnë mbi tokë në vend të udhëtimeve të gjata mbi det. Ju mund të keni parë grupe lejlekësh që mbulojnë qiellin në kohë të veçanta të vitit. Kjo ndodh sepse ata preferojnë të shtegtojnë mbi tokë. Ju, ndoshta, mund të mos jeni në dijeni të faktit që mbi det nuk ka ajër të ngrohtë, por lejlekët e dinë këtë shumë mirë.

Në anën tjetër, albatrosët, pulëbardhat dhe zogj të tjerë të detit kursejnë energji duke përdorur rrymat e ajrit që shkaktohen nga valë të larta. Këta zogj deti që fluturojnë mbi valë, përfitojnë nga forca ngritëse e ajrit që i çon lart.

Siç shikohet dhe në shembujt e dhënë, të gjithë zogjtë janë në dijeni mbi teknikën që duhet të përdorin, ku do të shkojnë dhe cilën rrugë do të marrin. Asnjë ngatërresë nuk krijohet gjatë fluturimit të tyre, sepse Allahu frymëzon çdo krijesë me



njohuritë që i nevojiten. Në Kuran, Allahu përmend lëvizjet e zogjve në ajër dhe thotë:

A nuk e shihni se çdo gjë në qiej dhe tokë e madhëron Allahun, madje edhe zogjtë me krahët e hapur? Allahu e di mënyrën se si luten dhe madhërojnë të gjitha krijesat. Allahu e di mjaft mirë se çfarë veprojnë. (En-Nur: 41)

ZOGU I UJIT QË ÇAN NËPËR UJË SI NJË GËRSHERË

Shumica e zogjve nuk mund të fluturojnë nëse krahët e tyre bien në kontakt me ujin, sepse uji bën që pendët e krahëve të ngjiten me njëra-tjetrën dhe i pengon zogjtë të lëvizin krahët. Megjithatë, edhe pse zogjtë ujorë zhyten në ujë gjatë gjithë ditës, asgjë nuk u ndodh atyre. Ju ndoshta mund të habiteni se si ndodh kjo.

Këta zogj kanë një vaj të veçantë në krahët e tyre që pengon pendët të bashkohen me njëra-tjetrën kur janë të lagura. Kështu, ata mund të zhyten pa probleme. Megjithatë, zogut ujor të quajtur biralie i mungon ky vaj. Si rezultat, ndryshe nga



zogjtë e tjerë ujqorë, ai nuk mund të zhytet në ujë për të gjuajtur. Si e siguron ai, atëherë, ushqimin e vet?

Allahu i Gjithëmëshirshëm ka krijuar pjesën e poshtme të sqepit të zogut më të gjatë se pjesa e sipërme. Njëkohësisht pjesa e poshtme është e ndjeshme ndaj prekjes. Për më tepër, krahët e këtij zogu ujqor janë krijuar aq të përkryer, sa që ai mund të rrëshkasë mbi sipërfaqen e detit për një kohë të gjatë pa i përplasur krahët fare. Ndërsa fluturon, zogu thyen sipërfaqen e ujit duke përdorur pjesën e poshtme si një gërshtë. Sapo kjo pjesë e sqepit prek gjahun, zogu menjëherë e ndjen dhe e kap atë. Ky zog është, gjithashtu, një nga provat e madhështisë së krijimit të Allahut.

**... Ai e di se ç'ka në tokë dhe në det. Ai është në
dijeni për çdo gjethë që bie. Nuk ka kokërr në
thellësi të tokës apo send i njomë ose e thatë që nuk
është në librin e qartë. (El-En'am: 59)**

*Ata të cilët i dëgjojnë fjalët dhe
ndjekin më të mirën prej tyre.
Ata janë besimtarët që Allahu i
udhëzoi në rrugën e drejtë...
(Ez-Zumer: 18)*



SEPJET E NGJASHME ME MOTORËT

Edhe pse quhet “peshk”, ndryshe nga peshqit e tjerë, sepja nuk ka hala në trupin e saj. Ju mund të pyesni se si këta peshq pa hala mund të lëvizin në ujë. Në të vërtetë, sepjet përdorin një mënyrë të veçantë për të lëvizur. Trupi i sepjes, që përbëhet nga ind i butë, është i mbuluar me një shtresë të trashë lëkure. Me anë të muskujve nën lëkurë, një sepje mbledh ujë brenda trupit të saj dhe lëviz duke lëshuar ujin jashtë.

Sistemi i sepjes, mbështetur në rrjedhjen e ujit, është shumë i ndërlikuar. Ky peshk ka dalje si xhepa në secilën anë të kokës. Uji nxirret nëpërmjet këtyre daljeve në një gropë në formë cilindri. Pastaj sepjet e derdhin ujin nga një tub i ngushtë me presion të madh menjëherë poshtë kokës. Kjo bën të mundur që kafsha të lëvizë me shpejtësi në drejtim të kundërt dhe të largohet me shpejtësi edhe nga grabitqarët që mund ta sulmojnë. Ju mund të pyesni veten se çfarë ndodh nëse shpejtësia nuk është e lartë sa duhet. Në këtë rast, sepjet spërkasin armikun me një



lëndë me ngjyrë të errët që prodhohet në trupin e kafshës. Kjo spërkatje i çorienton grabitqarët për pak sekonda, të cilat janë të mjaftueshme për një sepje të largohet me shpejtësi. Ajo ikën nga vendi dhe zhduket nëpër lëndën e spërkatur.

Si të gjitha gjallesat e tjera, ky tipar i sepjes është shprehje e krijimit të Allahut.

I Madhëruar qoftë Allahu, i Gjithëfuqishmi, i Vërteti! Nuk ka të adhuruar të vërtetë tjetër veç Tij, Zoti i Arshit të madh.


(Ez-Zumer: 10)

PATAT E EGRA

Patat e egra, të quajtura greilag, mund të fluturojnë në lartësi afro 8,000 metra. Kjo është, në fakt, një detyrë shumë e vështirë përderisa shumë gjallesa nuk mund të marrin frymë në lartësi të tilla për shkak të mungesës së oksigjenit. Kjo është arsyeja pse ne marrim frymë me vështirësi kur ngjitemi nëpër male. Duke fluturuar në një largësi që ka një mungesë ajri, zogjtë kanë nevojë të përplasnin krahët sa më shpejt.



**Çdo gjë në qiej dhe në tokë i përket vetëm Atij. Ai e di gjendjen tuaj (besimin apo hipokrizinë). Ditën kur do të kthehen tek Allahu, Ai do t'u tregojë për ato që punuan. Allahu di çdo gjë.
(En-Nur: 64)**



Me qëllim që krahët të lëvizin më shpejt, zogu do të shpenzojë më shumë oksigjen, që e bën gjendjen edhe më të vështirë për të. Megjithatë, këta zogj nuk përballen me ndonjë vështirësi kur janë duke fluturuar në lartësi prej mijëra metrash. Kjo ndodh në saje të mushkërive e tyre të veçanta, që përdorin oksigjenin e pakët në lartësi të tilla.

Duke funksionuar në një mënyrë tjetër nga ajo e gjallesave të tjera, mushkëritë e këtij zogu bëjnë të mundur që të fitohet energji nga një atmosferë me ajër të rralluar. Edhe kjo është një nga provat e krijimit të përkryer të Allahut.

SISTEMI I PAKRAHASUESHËM I SIGURISË

Disa gjallesa, duke jetuar afër sipërfaqes së ujit, janë të ndjeshme ndaj rreziqeve si sipër ujit ashtu dhe poshtë tij. Këto gjallesa kanë një sistem të pabesueshëm sigurie: ato janë të tejdukshme. Siç edhe mund ta shikoni në foto,



ato janë të padukshme për armiqtë e tyre. Në mënyrë të ngjashme gaforret, karkalecat e detit dhe larvat e peshqve janë të krijuara pothuajse të tejdukshme.

Sigurisht që këto krijesa nuk mund të kenë marrë në konsideratë mjedisin ku jetojnë dhe pastaj të kenë përshtatur ngjyrën e saktë. Përveç kësaj, si mundën këto kafshë të dinë se çfarë u nevojitet për t'u mbrojtur? Si mundën ato të jenë në dijeni të pranisë së grabitqarëve dhe të arrijnë në përfundimin se nuk do të vihen re, sepse janë të tejdukshme?



A mund të dalloni një karkalec deti të tejdukshëm në këto figura? Këto krijesa, trupat e të cilave Allahu i ka krijuar të tejdukshëm, mund të shihen me shumë vështirësi nga armiqtë e tyre.



Allahu, i Cili krijoi gjithçka në mënyrë të përsosur, i krijoi këto gjallesa të vogla, të mbrojtura nëpërmjet një sistemi të përkryer. Allahu sheh gjithçka dhe ka krijuar sisteme të veçanta mbrojtjeje për çdo krijesë. Edhe këto krijesa janë të mbrojtura nga grabitqarët e tyre në saje të tejdukshmërisë. Në një ajet kuranor është përmendur se krijimet e Allahut janë të pakrahasueshme:

Allahu është Ai që ka krijuar shtatë qiej mbi njëri-tjetrin. Ju nuk mund të shihni asnjë gabim në krijimin e të Gjithëmëshirshmit. Shikoni pësëri..! A shihni ndonjë të çarë? Atëherë shikoni pësëri dhe pësëri... (El-Mulk: 3-4)





125



PËRFUNDÏM


Në këtë libër u njohëm së bashku me disa shembuj të gjallesave të mrekullueshme që Allahu ka krijuar. Duke treguar këto tipare të mrekullueshme dhe disa modele të sjelljes inteligjente në këto krijesa, kishim për qëllim t'ju ndihmonim të kuptonit edhe një herë se këto nuk mund të kenë ardhur në jetë vetvetiu dhe se është Allahu ai që i krijoi të gjitha këto.

Siç jeni në dijeni, shembujt e dhënë në këtë libër pasqyrojnë vetëm një numër të vogël të krijesave të gjalla në këtë botë. Ka miliona lloje gjallesash që jetojnë në det, në tokë ose në ajër. Të gjitha këto krijesa kanë sisteme të ndryshme organizimi dhe modele të ndryshme sjelljesh. P.sh., një zog nuk sillet kurrë si një tigër dhe mënyra se si ushqehet elefanti nuk është e njëjtë edhe për rosën. Një krokodil jeton si në ujë, ashtu edhe në tokë, kurse një majmun nuk mund të jetojë në ujë.

Shkurt, karakteristikat dhe tiparet e gjallesave janë të veçanta për secilën. Pamja e jashtme e tyre, mënyra se si ushqehen dhe




KRIJESA TË MREKULLUESHME



kujdesen për të vegjëlit janë, gjithashtu, të ndryshme nga njëra tek tjetra.

Ju e dini që është Zoti ynë Ai që i krijoi të gjitha këto krijesa së bashku me karakteristikat e tyre të veçanta dhe u mësoi atyre gjithçka që ato bëjnë. Nëse nuk e keni ditur më parë, atëherë tashmë e mësuat këtë fakt duke lexuar këtë libër. Tregojuni edhe të tjerëve çfarë keni mësuar! Tregojuni të tjerëve se Allahu i krijoi të gjitha krijesat dhe se larmia e jashtëzakonshme e gjallesave tregon mençurinë e pashoqe të Zotit tonë.

Mos harroni, gjithashtu, se Allahu do t'ju dojë më shumë dhe do të krijojë më shumë mirësi për ju si në këtë jetë, ashtu edhe në jetën tjetër për atë që bëni. Kurrë mos harroni e mos





127



ngurroni të jeni njeriu që do

Allahu, i Gjithëmëshirshmi, Zoti i gjithçkaje.

Duke u treguar të tjerëve rreth ekzistencës se Allahut dhe duke u sjellë mirë me të tjerët, ju do të keni vepruar drejt dhe do të shpërbleheni më së miri nga Zoti ynë. Në këto ajete, Allahu u jep lajme të gëzueshme atyre që bëjnë mirësi:

Nuk është ashtu! Të gjithë ata që janë dorëzuar tek Allahu dhe janë bamirës do ta marrin shpërblimin e vet nga Zoti i tyre dhe ata nuk do të kenë frikë as nuk do të mërziten.

(El-Bekare: 112)




Kush bën vepra të mira, do të shpërblehet edhe më mirë se ajo që ka punuar dhe do të jetë i siguar prej tmerrit të asaj dite. (En-Neml: 89)

Engjëjt thanë: "I lavdëruar qofsh Ti! Ne nuk kemi dije tjetër përveç asaj që na mësove Ti. Ti je i Gjithëdijsmi, i Urti." (El-Bekare: 32)

KRIJESA TË MREKULLUESHME



LIBRA TE BOTUAR NGA HARUN JAHJA



LIBRA TE RINJ

